



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.4(453)

PRILL 2026

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

**PORTRET**

**ADEM JASHARI, HEROI I LIRISË**

*Luftëtari i ardhshëm i lirisë u rrit dhe u edukua me frymën e atdheadashurisë nga babai Shaban Jashari*




Prof. dr. Akademik Flori Bruqi

FAQE 4

**LIBRI**

**DANTJA YNË PA NOBEL DHE LIBRI I TOPOLLAJT, QË RIHAP DEBATIN PËR GJENIUN KADARE**



FATMIR MINGULI

FAQE 8

**100 VJETORI I LINDJES**

**BASHKIM KOZELI: DISA KUJTIME PËR VËLLA BEGATORIN**



FAQE 10

107 VJETORI I LINDJES - Libri "Gjenerali që sfidoi kohërat" është i ngushtë për kostumin e Heroit të Popullit dhe "Nderit të Kombit"

# GJENERAL PARLLAKU, JETË E "SHTRYDhur" NË NJË LIBËR

**DWD**

**"NJË LEGJENDË NË KUFIRIN E DY KOHËVE"**

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

**P**ara dymbëdhjetë vitesh, kur me bashkautor Sakip Camin shkruam dhe botuam monografinë "Rahman Parllaku – Një legjendë në kufirin e dy kohëve", shkrimtari i mirënjohur Teodor Laço (në parathënie) do të shprehej se nuk është thjesht një biografi tërheqëse, që për një shkrimtar do të qe një grishje për fantazinë. Është më shumë se kaq. Është një dëshmi për kohën që kemi lënë pas, për një kohë tepër të gjatë, si dhe jeta e heroit të librit, që jetoi mbi një shekull, dhe që si rrallëkush deri sa zemra e tij pushoi së rrahuri përgjithmonë (më 15 shtator 2019), mbarte dhe frymëzonte, me freskinë fizike, me mprehtësinë e gjykimit, me fjalën që nuk i binte përdhë, me gjallërinë dhe energjinë e një burri shteti...

(Vijon në fq.4)



*"Po mbushen dhjetë vjet pas thirrjes, (Nëntor 2016, sot 2026), drejtuar kryetarit të Kuvendit dhe të gjithë kryetarëve të partive politike, pjesëmarrëse në Kuvendin e Shqipërisë. Një "Platformë pajtimi", me vlera atdhetarie, që mund të ndryshonte ndjeshëm ndjesinë dhe trashëgiminë e përcarjes politike që vazhdon edhe sot e kësaj dite, si vazhdim i "Luftës së klasave", trashëguar nga diktatura...."* **Nga Kadri TARELLI** FAQE 2-3

**ERMAL NUFË MERR DREJTIMIN E MBROJTJES: MODERNIZIMI I FA DHE RIJETËZIMI I INDUSTRISË USHTARAKE, PRIORITET...** FAQE 16

**OPINION**

**Ajatollahu, fati i çdo sundimtari gjakatar**

Gjeneral @ Piro Ahmetaj

FAQE 6

**LETRAT**


**EDHE PESË YJE NDRIÇOJNË MBI TIRANË**

Poezi nga FRAN CARA

FAQE 14

**PËRURIMI**

*Një kuvend letrar, kushtuar romanit biografik "Çili". (Besniku i zemrës)*



**HASAN M. SHAHINAJ MES ARSIMIT, LETËRSISË DHE GAZETARISË**

FAQE 15

**82-VJETORI**

**BRIGADA E VIII-të S SHKROI ME GJAK TRIUMFIN NDAJ FASHIZMIT**

FAQE 5

**80-VJETORI I RËNIES**

**HERONJ TË HESHTUR QË DUHEN PËRKUJTUAR**

Prof.asc.dr. Bernard ZOTAJ

FAQE 6

**STUDIMI**

**ZHVENDOSJET E QYTETIT TË PUKËS GJATË 110 VITEVE**

XHEMAL MEÇI - Mjeshtër i Madh

FAQE 11

**PROFILI**

**DR. ELTON QELI KARDIOLOGU QË SHËRON ZEMRAT DHE SHPIRTRAT E NJERËZVE**

Nga Sakip CAMI

FAQE 13

**ESSE**

**LETRAT E USHTARIT GREK DHE E MAJORIT RUS NGA MALET E EGRA TË SHQIPËRISË**

Sefer Pasha

FAQE 9

## 107 VJETORI I LINDJES

Libri “Gjenerali që sfidoi kohërat” është i ngushtë për kostumin e Heroit të Popullit dhe “Nderit të Kombit”


# GJENERAL RRAHMAN PARLLAKU

## Një jetë e “shtrydhur” në një libër



*Ka beteja që duken të përjetshme, por nëse vazhdon të besosh në veten tënde, bota nuk do të ketë zgjidhje tjetër, veçse të të dëgjojë.*

*Al Paçino*



### Kadri TARELLI

Nënkryetar i degës së OBVLP  
Durrës

#### PSE NUK U DËGJUA ZËRI I TIJ?! – SHQIPËRIA DO TË ISHTE NDRY- SHE

Mbase jam vonë në kohë, po lexoj librin “Rahman Parllaku, Gjenerali që sfidoi kohërat”, libër i botuar kohë më parë, që unë e quaj më shumë, një “Monografi politike”, të autorëve Halil Rama dhe Sakip Cami.

Mendoj se kam të drejtë ta quaj kështu, pasi e gjithë jeta dhe veprimtaria e Gjeneralit, pas moshës 20-vjeçare, është përfshirë në politikë. Si fillim me njësitë guerile në qytetin e Vlorës, në Luftën antifashiste gjatë Luftës së II-të Botërore. Më pas rreshtuar në formacionet ushtarake partizane, me detyra të ndryshme, komandant e komisar të njëjve ushtarake, që luftuan edhe jashtë kufijve tanë, deri në Sanxhak të Bosnjës, përfshi edhe në Dardani.

Për merita të veçanta i është dhënë titulli “Hero i popullit” dhe “Nderi i kombit”. Është dekoruar me 9 urdhra e tre medalje të luftës dhe 3 urdhra të shërbimit ushtarak.

Më duhet të them që në fillim, se ky libër “Monografi”, ka një qasje të veçantë, pasi bën fjalë për një ushtarak, i cili qëndroi dhe arriti detyra të larta shtetërore, gjithmonë në fushën ushtarake. Kështu shumë hollësi nuk mund të bëheshin pjesë e njohjes nga lexuesit e shumtë. Ushtria ka në themel të saj “urdhrin” dhe “Sekretin”, jo vetëm të forcave, kuadrit drejtues, armatimit, stërvitjen, etj, etj, por edhe problemet që hasen gjatë kohës së shërbimit. Të gjitha mbeten të heshtura, të mbyllura. Kështu që libri paraqet interes të veçantë, për t’u lexuar me nge dhe pa u ngutur.

#### NJË “MUZE” I NDËRTUAR NË LETRA

Nuk jam i vetmi që e them, se libra të tillë janë një “Muze” i ndërtuar në letra, që përfshijnë histori dhe i shërbejnë his-

torisë. Studiuesit me të drejtë, historinë e quajnë të ftohtë për personazhet dhe ca më shumë për lexuesin. Ndaj po shtyhem të pyes: - “Po a mund të jetë e ftohtë një vepër ku ka jetë që gjallon e lëviz në kohë pa kohë, siç ndodhi me Gjeneralin....!?”

I përshëndes autorët, pasi nuk është e lehtë të përmbledhësh rreth 80 vite të jetës politike të këtij ushtaraku, përfshirë gjerësisht në ngjarje të trazuara që ndiqnin njëra-tjetrën, si një orë e kurdisur keq. Ishte ndershmëria, burrëria dhe mençuria e këtij njeriu, që mundi të përballojë situata të vështira, madje edhe burgosje, për faje që nuk i kishte bërë.

Gjenerali, duke qenë në rangun e lartë të detyrave në Parti dhe shtet, pati mundësi të njohë nga afër të gjithë drejtuesit e kohëve, që gjatë luftës e në vazhdim, pikërisht ata që krijuan histori dhe mbetën në histori, për të cilët jep vlerësimet e tij, si njerëz, si drejtues dhe si shtetarë. Mund të përmend: Sejfulla Malëshova, Nako Spiru, Enver Hoxha, i cili në ato vite të para e priste edhe në shtëpi, Riza Dani, Ramiz Alia, Mehmet Shehu, Koci Xoxe, Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako, Panajot Plaku, Fadil Hoxha në Dardani, etj, etj..... Çuditërisht shumica të eliminuar nga diktatura, me akuza të sajura.

#### “NGRITJA E ZËRIT NUK TREGON AS FORCË AS ZGJUARSË”

Në këtë udhë mendimi, më ka mbetur e skalitur në mendje një thënie e gjeneralit, si mësim për të gjithë ata që marrin detyrë, se ngritja e zërit nuk tregon as forcë as zgjuarsë: - Kur u ngrit në përgjegjësi, Ministri i mbrojtjes i tha: “Në këtë detyrë të duhet ta ngresh zërin dhe të tregohesh më i rreptë, pasi ke shumë reparte në varësi”. Gjenerali u përgjigj: - “Nuk mund të ndërroj karakterin sa here ndërroj detyrën, por kam besim se edhe pa bërë titull do ta plotësoj detyrën”. Faqe 124 Një meritë e autorëve vlen t’i thuhet në sy: - Ata mjeshtërisht i janë shmangur komenteve apo diskutimit të ngjarjeve, duke lënë të flasin vetëm dokumentet dhe vetë Gjenerali, duke e lenë këndonjësin, (si puna ime), të gjykojë e të vlerësojë çdo veprim, duke i veshur kostumin secilit, sipas masës, modës dhe ngjyrës. Në këtë këndvështrim, libri “Monografi” është i ngushtë për kostumin e Gjeneral Parllakut, që i përjetoi dhe përcolli të gjitha ngjarjet madhore, duke qenë vetë aktor dhe spektator, që nga Kongresi i Përmetit, maj 1944, çlirimi, zgjedhjet parlamentare 1945 dhe eliminimi i grupit të deputetëve, kërkesat e udhëheqjes Jugosllave për bashkimin

e Shqipërisë në Federatën Jugosllave, si fillim me bashkimin ekonomik e më pas, vendosjen e ushtrisë nën një komandë ushtarake, duke u shndërruar kështu në Republikë të shtatë.

Më tej, ngjarje e madhe: Kongresi i Parë në vitin 1948, eliminimi i një numri të madh kuadrosh që kishin bërë luftën N. Çl. Me pretekstin si mbështetës të Federatës Jugosllave. Shkëputja nga Jugosllavia dhe lidhja me Bashkimin Sovjetik. Më tej ngjarjet e viteve 1960-1961, shkëputja nga Kampi Socialist, largimi i flotës luftarake të Traktatit të Varshavës, lidhja me R.P. të Kinës. Etj, etj.

#### “FSHESA E HEKURT” NË USHTRI, E TRISHTUESHME E PLOT DHIMBJE

Ngjarjet rrjedhin e ndjekin njëra-tjetrën. E papritur “Heqja e gradave në ushtri”, 1967-1968, vendosja e komisarëve politik. E trishtueshme dhe plot dhimbje, “Fshesa e hekurt”, në ushtri gjatë viteve 1973-1974, dhe eliminimi i një numri kuadrosh drejtues, mes tyre edhe Gjenerali ynë, që shpëtoi nga pushkatimi, por u dënua me 25 vjet burg.

Unë e quaj fat për Gjeneralin, që shpëtoi, kur të tjerët u pushkatuan: Beqir Balluku, Petrit Dume dhe Hito Çako.

Vijon në faqen 3

## LIBRI

Libri “Gjenerali që sfidoi kohërat” është i ngushtë për kostumin e Heroit të Popullit dhe “Nderit të Kombit”

# GJENERAL RRAHMAN PARLLAKU

## Një jetë e “shtrydhur” në një libër

Vijon nga faqja 2

Jeta nuk ka çmim. E quaj fat edhe për ne, për të na sjellë të gjallë çastin e arrestimit në mjedis publik, një lloj terrori i pëlqyer dhe ushqyer nga diktatura dhe diktatori, po ashtu edhe mbajtja për disa muaj në tortura në hetuesi dhe nëpër burgje.

Nuk jam cinik që kënaqem me vajtjet e njeriut, të shkaktuar nga njeriu, kur njihem me dhunën çnjerëzore që përdorte hetuesia dhe prokuroria mbi të akuzuarit, përfshi edhe Gjeneral Parllakun, me aq shumë dekorata e vlerësime, të cilin pak ditë më parë, e nderonin duke e vënë në sofrën e parë. Po vaj halli për të tjerët, që s'ishin si ai.....!? - Ç' mund të themi për torturat që hoqën ata që cilësoheshin “Armiq të klasës”, “Armiq të Pushtetit”, për të cilët me qesëndisje, sot thuhet e quhet, “Letërsi burgu”. Po dhimbjet e Gjeneralit si mund t'i quajmë.....? Vallë a ka përkufizim dhimbja e njeriut, veçanërisht kur është i pafajshëm.....!?

Them përsëri, - “Ishte fat për ne”, sepse kujtesa dhe dëshmia e tij na ndihmon të kuptojmë, se si vendoste prokuroria dhe gjykata tërësisht politike, në diktaturë. Besoj mjafton ky shënim, ku prokurori, thotë: - “Akoma beson se do të mbrohesh, kur akuzën e ka përcaktuar ai lart.....?! Ne po bëjmë formalitetin këtu”. Faqe 329. - Mos o zot, më keq....! Mjerë ai që futej në listat dhe ingranazhet e organeve të dhunës.

### GJENERAL PARLLAKU, NDËR TË PAKTËT NJERIEZ QË KËRKOI FALJE PUBLIKE

Libri na mbush mendjen, se gjithçka qenka plotësisht e vërtetë, ndërkohë duhet besuar, sepse e pranon dhe na rrëfen edhe Gjenerali. A nuk të dridhet zemra, kur lexon rrëfimin që të ngjeth mishin: “Një portokall në qeli, në natën e vitit të ri”. Etj, etj. Faqe 190. Një skicë e thjeshtë, që fare mirë mund të bëhet novelë, roman apo edhe film, ku ndërthuret dhuna dhe shpirti njerëzor. Fisnikëria nuk dhurohet, ajo lind në shpirt dhe vdes me shpirtin.

Unë e vlerësoj librin edhe për disa arsye, në dukje fare të thjeshta:

. Si fillim: Gjenerali është ndër të pakët njerëz që kërkon falje publike, duke qenë dikur i përfshirë në strukturat e larta drejtuese të shtetit. Lexoni këto pak radhë: -“Ndjesë publike, si bashkëpërgjegjës për krimet e diktaturës komuniste. Jo se kam qenë i përfshirë drejtpërdrejt apo i implikuar në krime e procese politike, por sepse më ra për pjesë të shërbeja në atë sistem makabër”. Faqe 314.

. Në vazhdim, “Letra nga burgu i Burrelit”, janar 1988. Letër e shkruar me vonesë, në vitin 1988, që i drejtohet udhëheqjes lart në kupolë, ku në krye bën thirrje për drejtësi: “Na burgosët padrejtësisht, mos na vdisni para kohe, ndaloni torturat çnjerëzore! - Ishte një thirrje që kërkonte drejtësi. - Po a e dëgjoi

kush...? - Mund të pyesë çdo këndonjë.

“Një letër që akuzon”, po e quaj unë. - “Kur isha në detyra të larta partie dhe shteti, kurrë nuk më shkonte mendja se bëheshin veprime të tilla antiligjore në pushtetin tonë”. - Shkruan Gjenerali. Faqe 192.

Besoj se janë mjaft këto pak fjalë. Por nuk e di sa ka besuar Gjenerali, për t'i prekur sado pak drejtuesit e shtetit që komandonin strukturat e dhunës, për të vendosur e prodhuar drejtësi. E vërteta është se edhe pas “letërs”, nuk u bë asgjë. Vetëm pas tre vitesh, kur diktatura u shemb në 1991, si gjithë të burgosurit politik, u lirua edhe Gjeneral Parllaku. (Mars 1991)

Në këtë letër, më bëjnë përshtypje këto pak fjalë, shkruar imët: - “Kjo letër është shkruar nga Burgu i Burrelit, ku nga 318 të burgosur, 298 prej tyre ishin bashkëluftëtarë të Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë”. Faqe 192.

Ç' koment mund t'i bëhet këtij shënimi, që në heshtje flet shumë!?

. Më kryesorja: “Thirrja për Pajtim Kombëtar”, pjesa më e ndritur e librit dhe e jetës së Gjeneralit. Do të mjaftonte vetëm ky veprim logjik dhe politik, që Gjeneral Rahman Parllaku të vendosej në pedestal të vlerave kombëtare.

Po mbushen dhjetë vjet pas thirrjes, (Nëntor 2016, sot 2026), drejtuar kryetarit të Kuvendit dhe të gjithë kryetarëve të partive politike, pjesëmarrëse në Kuvendin e Shqipërisë. Një “Platformë pajtimi”, me vlera atdhetarie, që mund të ndryshonte ndjeshëm ndjesinë dhe trashëgiminë e përçarjes politike që vazhdon edhe sot e kësaj dite, si vazhdim i “Luftës së klasave”, trashëguar nga diktatura.


Qofsha i gabuar, por Gjeneral Parllaku është i pari dhe i vetmi që ndërmerr një hap të tillë politik. Nuk di si ndjehen sot pjesëmarrësit në atë takim historik? - A i vret sadopak vetëdija kombëtare...!? - Pse nuk vepruan për ta ndryshuar këtë realitet të dhimbshëm...? - Kush i pengoi? - Pse heshtën si murgu në qeli...? - Harrojnë se Partitë shkojnë e vijnë, ndërta kombi rron në shekuj. Më keq akoma, kur “përçarja”, i shërben interesit të Partive, apo interesit vetjak, (Një bythë për karrigen e pushtetit).

Paçin faqen e zezë....! Historia ndëshkon, nuk harron....! I madh bëhesh dhe mbetesh, vetëm kur i shërben kombit dhe mëmëdheut.

Mbase e teproj, por libri po më shpon dhe po ma kujton diçka më shumë: - Unë, si pjesa dërmuese e shqiptarëve, shpresuam se kjo plagë vrastare e përçarjes, e mbjellë dhe e rritur për 50 vjet, do të mbyllej me “Pajtim Kombëtar”, që në ditët e para të demokracisë. Nuk u bë as atëherë, as në ditët e sotme. Pyetja “Pse?”, ngrin në buzë. Nuk dinin apo nuk donin.....!? E para nuk më bind, e dyta është më e besueshme, por dhemb si plagë e pambyllur, sa herë preket.

Gjeneral Parllaku e tha fjalën e tij. Ai ndërroi jetë, duke mos e parë të realizuar

Halil Rama  
Sakip Cami



**RRAHMAN PARLLAKU**  
Gjenerali që sfidoi kohërat

BOTIMET M&B

këtë ëndërr shekullore, të dëshiruar nga të gjithë Shqiptarët.

. Këndonjësi nuk do të lodhet të gjejë në vazhdim, se duhet përmendur veprimtaria për një kohë të gjatë, si anëtar themelues, më pas edhe drejtues i OBVL, prej gati 35-vjetësh. Duke e bërë të njohur këtë organizatë, jo vetëm brenda vendit, me një numër të madh anëtarësh, por të njohur edhe ndërkombëtarisht, në Ballkan dhe në botë, si anëtare e denjë e 123 vendeve në “Federatën Botërore të Veteranëve”, ku aderojnë rreth 150 milion anëtarë.

. Siç po vërej në libër, mendoj se nuk duhet ta kaloj në heshtje, një tjetër fushë, ku Gjenerali shpërfaq kulturën dhe guximin për të thënë të vërtetën. Bëhet fjalë për publicistikën ku ka shumë artikuj të pasqyruar në shtypin e kohës. Një tregues i shkëlqyer i përkushtimit ndaj problemeve madhore që kaloi dhe po kalon vendi ynë. Një personalitet që gjithë

jetën është marrë me veprimtari politike, nuk mund të qëndronte indiferent, pa varësisht moshës që e mbushi dhe e kaloi një shekull jetë intensive.

### HEROI QË BËRI EPOKË

Nuk mund të rri pa përmendur kohën e studimeve të Gjeneral Parllakut, në Akademinë “Vorshillov”, në Moskë, nga më të njohurat në ish Bashkimin Sovjetik. Është një përvojë jete që të lë pa fjalë dhe që mund të frymëzojë cilindo, veçanërisht të rinjtë. Këtu preket dhe përjetohet gjatë, guximi dhe burëria e një shqiptari, si Rahman Parllaku, i dalë pa shumë shkollë, nga rrethanat e jetës dhe nga lufta partizane, i cili arin të mbarojë shkëlqyeshëm akademinë, duke ua kaluar edhe atyre që kishin mbaruar akademi dhe shkolla ushtarake në vendet e tyre.

Vijon në faqen 4

## EDITORIAL

# “Një legjendë në kufirin e dy kohëve”



**Halil RAMA – Mjeshtër i Madh**

(vijon nga fq. 1)

Nga jeta e një Matuzalemi si Ai, na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur.


Do të mjaftonte qoftë edhe vlerësimi i shkrimtarit, politikanit e politologut Laço për të konkluduar në pavdekësinë e gjeneralit që bëri epokë, si legjendë në kufirin e dy, por tri kohëve.

Këtë 17 prill mbushen 107 vjet nga ditëlindja e Rrahman Parllakut - gjeneralit që bëri epokë.

Ai ishte i veçantë jo vetëm për moshën 100-vjeçare që jetoi, por sepse si shumë rrallë tjetër në udhëtimin e tij shekullor i ka jetuar të gjitha: mjerimin, varfërinë, luftën, paqen, fuqinë e pushtetit dhe persekutimin e pamëshirshëm të regjimit totalitar. Rrugëtimin 100-vjeçar, Gjenerali Parllaku e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare e pa eksploruar plotësisht.

Ai ishte partizanit fitimtar, komandanti dhe gjenerali legjenrat, por edhe i mbijetuarit i një brezi sakrificash e privacionesh të jashtëzakonshme, që gjatë një shekull jetë, ishte monument i thënies lapidar: “Rrno për me treguel!”. Kjo sepse ai përshekoi plot një shekull, një jetë e lavdishme në tri epoka; partizan dhe komandant legjendar antifashist; qëndrestar i burgjeve komuniste, si dhe një veteran me arsye dhe zë të kthjellët në mbështetje të demokratizimit të vendit pas viteve 1990.

I ngjizur në urtinë e odave lumjane dhe i burrrëuar në Labëri, përgjatë 100 viteve Rrahman Parllaku mbeti “dëshmitar i gjallë” për të gjitha ngjarjet e një shekulli. Rrallë gjen shembuj të personalitetit ku të jenë jetësuar në mënyrë kaq mjeshtërore vetitë e karakterit të një patrioti, të një ushtaraku të mençur, fisnik, të ndershëm dhe patriot. Rrahman Parllaku, ishte dhe mbetet i veçantë jo vetëm për 100 vitet që jetoi, por sepse si shumë rrallë tjetër në udhëtimin e tij shekullor i ka jetuar të gjitha: mjerimin, varfërinë, luftën, paqen, fuqinë e pushtetit dhe persekutimin e pamëshirshëm të regjimit totalitar. Rrugëtimin 100-vjeçar, Gjenerali Parllaku



e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare e paeksploruar plotësisht.

Ne krenohemi me gjeneral Parllakun – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, pasi, në jetën dhe veprën e tij janë ulur këmbëkryq urtësia e burrit të malësisë, trimëria, shpirti i lirisë dhe atdhedashuria e luftëtarit antifashist dhe e komandan-

tit partizan, si dhe angazhimi qytetar plot përkushtim.

Si uji i kristaltë i lumit të bjeshkës ka rrjedhur jeta e këtij njeriu që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë 100 viteve. Jeta dhe vepra e tij flet më fort se mijëra fjalë. Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e gjeneral Parllakut, atë e për shkon frymëzimi dhe dashuria për atdheun e tij, si lajtmotiv vijues mbikohor, që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e tij është një shëmbëlltë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar, ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigant hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë.

Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situata të ndryshme, pati edhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përulën gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptari, që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare.

- *Ne krenohemi me gjeneral Parllakun – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, pasi, në jetën dhe veprën e tij janë ulur këmbëkryq urtësia e burrit të malësisë, trimëria, shpirti i lirisë dhe atdhedashuria e luftëtarit antifashist dhe e komandantit partizan, si dhe angazhimi qytetar plot përkushtim*

“Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përbaljes në gjyqë ushtarake, përballoi burgje e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua heroit herë me tufa me lule, herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit, ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime. Ai është një model i ardhur nga gjencidit komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja”, shkruan Prof. asc. dr. Hajri Mandri në parathënien e librit “Gjeneralit që sfidoi kohërat. Mbi 20 vjet në krye të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it me ndershmëri dhe principe të larta morale, ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike, duke dhënë edhe në moshë pensioni një ndihmesë të vyer në emancipimin politiko-shoqëror e demokratik të shoqërisë. Si një lundërtar i shquar, ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë.

Jo vetëm gjatësia kohore e jetës, por dendësia dhe përmbushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bën këtë figurë të lartësuar në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e tij dëgjohen deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim, gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar.

\* Mjeshtër i Madh

## GJENERAL RRAHMAN PARLLAKU NJË JETË E “SHTRYDHUR” NË NJË LIBËR

Vijon nga faqja 3

Besoje, se si mësues që e nisa dhe e grisa jetën në arsim, mund të shprehem me një kërkesë, që ua drejtoj kolegëve mësues e drejtues shkollash, sepse shumë herë vuajmë të gjejmë heronj, të cilët mund të frymëzojnë nxënësit dhe të rinjtë tanë.

Shpesh shtyhem të marrim shembuj edhe nga letërsia botërore. Mjerisht, duke harruar heronjtë që i kemi në mesin ton dhe nga rrënjët tona. (shpesh për mungesë informacioni).

Nuk gaboj që po e rëndoju fjalën: Ky është faj, jo gabim. Janë strukturat që duhet të mendojnë. Dikush duhet ta

shtyjë më tej problemin dhe “heronjtë tanë”, të gjejnë vendin e duhur në programet mësimore, në arsimit 9-vjeçar dhe atë të mesëm. Përvoja pozitive në jetë, e vlen të përgjithësohet dhe përvetësohet për të ecur përpara me forcën e mendjes, guximit, durimit dhe vullnetit.

Duke tejkaluar zgjatjen e shkrimit, besoj se e vlen të përmendet edhe një tjetër anë, ajo letrare dhe krijuese. Gjenerali Parllaku i la si trashëgim letërsisë dhe historisë edhe tre librat e tij: “Mirënjohje për familjet vlonjate, që më mbajtën si birin e tyre”; “Kosova e lirë. Ëndrra e jetës sime” dhe “Memoria historike e kombit.

Besoje nuk është pak...! Po a janë

thënë të gjitha...!? Jam i bindur se ka ende shumë për të thënë, për jetën edhe veprën e këtij “Heroi” që bëri epokë.

Mbeten profetike këto pak fjalë, si amanet për vete dhe për ata që mund të njohin sado pak jetën dhe veprimtarinë e Gjeneral Rrahman Parllaku:

- “Në këtë jetëgjatësi, jam përpjekur t'i shërbej me ndershmëri popullit dhe atdheut tonë të shtrenjtë”.

Koha do ta çmojë jetën dhe veprën e tij...!

Urime autorëve Halil Rama dhe Sakip Cami! Një vepër e tillë ju nderon!

**Kadri Tarelli**  
Durrës. Mars 2026.

## PORTRET

*Luftëtari i ardhshëm i lirisë u rrit dhe u edukua me frymën e atdhedashurisë nga babai Shaban Jashari,*



**Prof. dr. Akademik Flori Bruqi**

Prishtinë, 2 mars 2026 -Nuk e mban mend kush në historik, që të flijohet gati një familje e tërë për lirinë e vendit. Dhe ja, ORA, urdhri për Liri a Vdekje tek erdhi në familjen Jashari të Prekazit. E tashmë të gjithë e dinë se festa e Flamurit është 28 Nëntori.

Mirëpo, kjo datë shënohet edhe si ditëlindja e komandantit legjendar Adem Jashari, i lindur më 28 nëntor 1955. Në atë gëzim, të porsalindurin e mbuluan me flamurin e Skënderbeut.

Luftëtari i ardhshëm i lirisë u rrit dhe u edukua me frymën e atdhedashurisë nga babai Shaban Jashari, dhe duke dëgjuar për ngjarjet me përmasa kombëtare, si dhe këngë për heronj të mëdhenj. Ai nuk e duronte dot robërinë. E dinte kur duhej të fliste dhe të heshte. Një veti e luftëtarëve të mëdhenj të Kosovës dhe gjithandej trojeve etnike shqiptare. Amanetin e tyre për çlirimin e vendit do ta përjetësojë në luftën çlirimtare, me një emër tashmë embleme: UÇK. Atëherë, duke ndjerë se Kosova kishte shumë nevojë për t'u çliruar nga pushtuesi i tmerrshëm, Adem Jashari tuboi rreth vetes ndër djemtë më trima, të cilët kapën armët për të luftuar gjer në fitore.

Luftëtari i lirisë, ishte shfaqur edhe në vitet '80-ta kur patën plasur demonstratat, ndërsa të '90-tatë po hynte në aureolën e lavdisë për të shënuar një epokë të re në historinë e Kosovës. Ishte një strateg dhe komandant i zoti, ndërsa sikur ta kishin të tjerët do t'ia kishin lakminë dhe do ta kishin ngritur gjer në qiell.

Të rrosh apo të mos rrosh, këtë dilemë hamletiane, Adem Jashari s'e kishte dot në mendje. Ishte mëngjes i hershëm, me ankthe, i 30 dhjetorit 1991, kur armiku me një makineri të tërë policore kishte rrethuar lagjen e Jasharëve dhe kërkonte dorëzimin e komandantit. Por, ai me tërë familjen, me të afërmit dhe me shokë të luftës, armikut iu përgjigjen me breshëri armësh. Ishte kjo pushka e parë që krisi në Drenicë. Komandanti legjendar tani ishte kudo me UÇK-në, të dalë në skenë, që më 28 Nëntor 1997, në Llaushë, një ush-

tri që u bë shpresë për popullin dhe tmerr për armikun. S'mund të ishte ndryshe, sepse Adem Jashari kishte prejardhje nga një botë e lavdishme, që madhërisht po hynte dhe në legjendë. Ai si Tezeu ia futi armikut frikën në shpirt, duke e sulmuar grykave, udhëkryqeve, stacioneve famëkeqe policore dhe kudo. Mirëpo, pushtuesi i tmerrshëm prapë në mëngjesin e 5 marsit 1998, ndërmori edhe një sulm me forca të mëdha policore dhe ushtarake. Adem Jashari me familjen e vet, me Jasharët e tjerë, me ata që ndodheshin në ato momente rreth tij, sulmuan nga çdo anë; as jepeshin dot; dhe lufta zgjati tri ditë e tri net. Luftëtari i lirisë ndriti me ditë, duke dalë si nga baladat. Pas asaj luftime të tmerrshme, armiku dogji shtëpi, shkatërroi kullën e trimit dhe lagjen e Jasharëve, vrau madje dhe fëmijë, por kurrë vendosmërinë për të vazhduar luftën.

## Brigada e VIII-të S shkroi me gjak triumfin ndaj fashizmit

*Për një prej formacioneve më të mëdha e më të shquara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare*

Tetëdhjetëedy vjet më parë, më 25 Prill 1944, në një lëndinë të rrethuar me lisa, me një bukuri të rrallë natyrore, në Sheper të Zagorisë u formua Brigada e VIII-të Sulmuese.

Fillimisht ajo pati një efektiv prej 950 partizanë të ardhur nga njësitë partizane të Grupit të parë të Kurveleshit, Çeta "Koto Haxhi", Batalioni "Misto Mame", Batalioni "Thanas Ziko" e të tjerë partizanë nga Qarku i Gjirokastrës, që të gjithë të sprovuar në luftime kundër armikut.

Me krijimin e Brigadës u formuan katër batalione me nga katër kompani, me një efektiv prej rreth 200-250 vetë. Komandant Brigade u caktua Asaf Dragodi, Zv/Komandant Koço Gjeci, Komisar Qazim Kondi dhe Zv/Komisar Rrahman Parllaku. Njëkohësisht u caktuan edhe komandantët e batalioneve e të kompanive.

Brenda tre mujash nga krijimi Brigada arriti të kishte një efektiv



Në çastet më të ndjeshme, ai luftoi duke kënduar gjer në rënie; dhe nuk ishte vetëm. Jo, vdekja e tij nuk është vdekje. Ushtria Çlirimtare e Kosovës humbi prijësin e

saj të madh, por fitoi komandantin legjendar, përgjithmonë i pavdekshëm, përgjithmonë në kujtesën e paharrueshme të popullit shqiptar. Tani çdo gjë është përjetësi...

*• Në çastet më të ndjeshme, ai luftoi duke kënduar gjer në rënie; dhe nuk ishte vetëm. Jo, vdekja e tij nuk është vdekje. Ushtria Çlirimtare e Kosovës humbi prijësin e saj të madh, por fitoi komandantin legjendar, përgjithmonë i pavdekshëm, përgjithmonë në kujtesën e paharrueshme të popullit shqiptar. Tani çdo gjë është përjetësi...*

*Adem Jashari*

*• Emrat e dëshmorëve të kësaj brigade, të shokëve dhe shoqeve të armëve, të cilët dhanë jetën për atdheun në moshën më të bukur, janë shkruar me shkronja të arta në panteonin e kombit shqiptar*

prej 820 partizanë e partizane. Operacioni i Qershorit 1944 ishte prova më e vështirë, por edhe kalitja vendimtare për Brigadën e 8-të Sulmuese. Komanda e Brigadës dhe ato të batalioneve morën të gjitha masat organizative e operative për vazhdimin e luftimeve, deri në çlirimin e plotë të vendit.

Më 5 qershor 1944 forcat e Brigadës së 8-të i zunë priturë një kollone gjermane me mbi 900 vetë që vinin nga Greqia. Luftimet u zhvilluan të ashpra në Skore, Sopik e Çatister nga Batalioni i 3-të që ishte në rrezik rrethimi. Një trimëri të rrallë tregoi skuadërkomandanti Ormen Boro, i cili me automatik e bomba dore u hodh si rrufe në llogoren e armikut në Sopik, duke asgjësuar një

mitraloz të rëndë dhe duke vrarë disa gjermanë. Pas përleshjesh të ashpra ai u vra edhe vetë duke mbetur përjetë në altarin e lirisë. Në këtë situatë armiku pësoi çoroditje, ndërsa forcat partizane po përparonin dukshëm.

Nga luftimet e suksesshme të forcave të Batalionit të 3-të dhe të kompanisë së 2-të në Skore, armiku u detyrua të tërhiqej, duke lënë në fushën e betejës 11 gjermanë të vrarë.

Nga radhët e partizanëve u vranë 5 veta dhe u plagos komandanti i kompanisë së 2-të Mustafa Demiri.

Më 13 qershor '44 Batalioni i 3-të sulmoi në befasi një njësi armike në

80-VJETORI I RËNIES

# HERONJ TË HESHTUR QË DUHEN PËRKUJTUAR



**Prof. asc. dr. Bernard ZOTAJ**  
– Mjeshtëri Madh

## HYRJE

Në historinë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të viteve të para të pasçlirimit, krahas figurave të njohura që kanë zënë vend në historiografinë zyrtare, qëndrojnë edhe dhjetëra e qindra emra të tjerë, më pak të përmendur, por jo më pak të rëndësishëm.

Këta janë "heronjtë e heshtur", njerëz të zakonshëm që, në rrethana të jashtëzakonshme, u shndërruan në mbrojtës të vendit dhe të rendit të ri shoqëror.

Rastet e Hito Iljaz Majkës, Nazif Qerim Ibraj, Namik Ismail Osmanit, Nebi Alem Llanaj, Shefit Shaban Zenaj dhe Veledin Nuredin Serjani përfaqësojnë tipologji të ndryshme të këtij brezi: luftëtar të terrenit lokal që bie në ndjekje të kundërshtarëve të armatosur; ushtarë që jepin jetën në një mision atdhetar dhe kuadro politik e ushtarak që vazhdonin përballjen dhe në periudhën e pasçlirimit. Në tërësinë e tyre, këto figura ndihmojnë për të kuptuar vazhdimësinë e konfliktit dhe sakrificës përtej momentit të çlirimit.

## NË MBROJTJE TË RENDIT TË RI: RASTI I HITO ILJAZ MAJKËS

Hito Iljaz Majka (1923-1946), nga Vranishti i Vlorës, i përket brezit të ri që u formua në kushtet e luftës dhe u aktivizua që herët në radhët partizane. Që nga viti 1942, ai mori pjesë në përpjekjet luftarake në zonën e Vlorës, duke u angazhuar në një sërë operacionesh si ato të Gjormit, Tragjasit, Vajzës, Shushicës dhe Mavrovës.

Pas çlirimit, si shumë ish-partizanë, ai u përfshi në strukturat e reja shtetërore dhe në aksionet për rindërtimin e vendit. Megjithatë, realiteti i viteve 1945-1946 dëshmon se përballja nuk kishte përfunduar. Grupa të armatosura kundërshtarë vepronin ende në terren, duke e bërë të domosdoshme organizimin e forcave të ndjekjes.

Në këtë kontekst, në dhjetor

1946, Hito Majka u vu në krye të një aksioni për neutralizimin e një grupi të arratisurish. Vendosja taktike e forcave dhe thirrja për dorëzim tregojnë një veprim të organizuar, por reagimi i armatosur i kundërshtarëve e ktheu situatën në një përplasje të drejtpërdrejtë. Në përfundim të saj, megjithëse objektivi u arrit, Hito Majka mbeti i vrarë në krye të detyrës, në moshën 23-vjeçare.

Rënia e tij dëshmon për një fazë të ndërmjetme historike, ku kufiri midis luftës dhe paqes mbetej ende i paqartë.

## SAKRIFICA PËRTEJ KUFIJVE: NAZIF QERIM IBRAJ NË BARI

Nazif Qerim Ibraj (1926-1946), gjithashtu nga Vranishti, përfaqëson një tjetër dimension të angazhimit shqiptar në fundin e Luftës së Dytë Botërore dhe menjëherë pas saj: atë të pjesëmarrjes në misione pranë forcave aleate.

I dërguar në Bari të Italisë, si pjesë e misionit shqiptar pranë Shtabit të forcave aleate të Mesdheut, ai u përfshi në një sërë detyrash humanitare dhe organizative: riatdhesimin e shqiptarëve të shpërndarë në Europë, trajtimin e të plagosurve dhe të sëmurëve, si dhe ndërmjetësimin për kthimin e të larguarve në vend.

Formimi i tij si partizan në Brigadën V Sulmuese dhe përvoja luftarake në disa fronte, brenda dhe jashtë vendit, e kishin përgatitur për detyra të vështira. Megjithatë, rënia e tij nuk ndodhi në një betejë të mirëfilltë, por në një situatë kaotike në qytetin e Barit. Në përpjekje për të shpëtuar një shok të plagosur, ai u qëllua dhe u godit për vdekje.

Ky episod nxjerr në pah rreziqet e vazhdueshme të periudhës së pasluftës dhe rolin e individit në situata ku kufiri midis detyrës ushtarake dhe aktit human bëhet i padalueshëm.

## "PROLETARI" SI FIGURË E KUADRIT POLITIK-USHTARAK

Namik Ismail Osmani (lindur më 1916), nga Kanina e Vlorës, përfaqëson tipin e kuadrit politik të dalë nga lufta.

Aktiv që në fillimet e rezistencës antifashiste, ai e ktheu shtëpinë dhe veprimtarinë e tij në funksion të organizimit të lëvizjes.

Pjesëmarrja në grevën e bukës të marsit 1942 dhe angazhimi i tij i hershëm si komunist dëshmojnë për një ndërgjegjësim të formuar politik. Pseudonimi "Proletari", me të cilin u njoh nga shokët, nuk ishte thjesht një nofkë, por një identifikim me idealin shoqëror që përfaqësonte.

Si komisar kompanie dhe më pas komisar batalioni në Brigadën V Sulmuese, ai veproi në një hapësirë të gjerë gjeografike, nga jugu në veri dhe përtej kufijve të Shqipërisë. Roli

i tij ishte thelbësor në ruajtjen e moralit dhe orientimit politik të forcave.

Pas çlirimit, ai u angazhua në strukturat e rendit të ri shtetëror. Episodi i përmendur në Shëgas të Myzeqesë, ku ai, pasi sigurohet për gjendjen e një ushtari të plagosur, rikthehet në vijën e zjarrit, ilustron vazhdimësinë e një etike veprimi që nuk ndryshon me ndryshimin e rrethanave historike.

## TRIM SI GJITHË TRIMAT...

Ka jetë që nuk maten me vite, por me peshën e qëndresës. Të tilla ishin jetët e atyre djemve që nuk kërkuan as lavdi, as kujtesë, por e fituan të dyja me gjakun e tyre.

Nebi Alem Llanaj lindi në vitin 1924, në Sevaster të Vlorës. Në fillim ishte një djalë që ndihmonte në heshtje partizanët, si shumë të rinj të kohës. Por brenda tij rritej një thirrje më e fortë: të mos rrinte pas, por të dilte përballë, me pushkë në dorë, në vijën e zjarrit.

Në mesin e vitit 1944, ai nuk priti më. Doli partizan. Fillimisht në batalionin "Perlat Rexhepi", më pas në Brigadën XII Sulmuese. Aty u bë një nga ata luftëtarë që nuk dallohen nga fjalët, por nga qëndrimi në momentet më të vështira.

Lufta mbaroi, por për Nebiun nuk kishte mbarim detyre. Shqipëria kishte ende nevojë për bijtë e saj. Ai vazhdoi shërbimin në repartet e ndjekjes, në vitet e vështira pas çlirimit.

Në korrikun e vitit 1946, në një nga ato ditë të nxehta që mbajnë erë pluhuri e ankthi, erdhi urdhri: "Nebi, merr skuadrën dhe nis menjëherë... përgatituni për një ndjekje të gjatë."

Ai nuk pyeti. Nuk hezitoi. Nuk kërkoi sqarime. Sepse kishte zgjedhur prej kohësh anën e tij. Brenda pak minutash ishte gati. U nis bashkë me shokët, si gjithmonë, i qetë, i vendosur, pa zhurmë. Dhe kësh-tu mbeti në kujtesë: si një njeri i thjeshtë në jetë, si një trim në luftë, si një bir që nuk e tradhtoi kurrë popullin e vet.

## NË NJË DITË TË NXEHTË KORRIK

Ka ditë që nisin si festë dhe mbyl-len si histori. Më 10 korrik 1946, në livadhet e Homeshit, dy njësi të ndjekjes kishin ndaluar për të shënuar ditën e ushtrisë. Ishte një çast i rrallë qetësie, mes një kohe që ende nuk kishte pushuar së provuari njerëzit e saj.

Mes tyre ishte edhe Shefit Shaban Zenaj, i lindur në vitin 1927 në Amonicë të Vlorës. Ishte ende i ri, por me një jetë që kishte kaluar përmes flakëve të luftës. Që 16 vjeç kishte dalë partizan, duke kaluar nga çeta "Kanan Maze" te batalioni "Perlat Rexhepi" e më pas në Brigadën XIV

Sulmuese.

Ai i përkiste atij brezi që u rrit brenda luftës dhe u pjek përpara kohe. Festa u ndërpre papritur. Një korrier solli lajmin: një njësi kishte rrethuar një grup armiqësor pranë Drinit dhe kërkonte përforcime të menjëhershme. Nuk pati hezitim. Nuk pati fjalë të tepërta. Vetëm lëvizje të shpejta dhe armë që u morën në dorë.

Me të mbërritur në vendngjarje, njësitë u shtrinë në formacion dhe u futën në pyllin e dendur. Pastaj nisi ajo që ata e njihnin mirë: përplasja. Plumbat përshkonin ajrin si fishkëllima të mprehta. Era e barutit mbuloi gjithçka. Zërat humbnin mes krismave. Aty nuk kishte më festë. Kishte vetëm detyrë.

Dhe në atë ditë korriku, mes vapës dhe flakës së armëve, u shkrua një tjetër faqe e heshtur e sakrificës, një nga ato që nuk bëjnë zhurmë, por mbeten gjatë në ndërgjegjen e një populli.

## RA ASHTU SI I KA HIJE NJË TRIMI

Ka rënie që nuk janë fund, janë dëshmi.

Veledin Nuredin Serjani, i lindur në vitin 1914 në Lapardha të Vlorës, ishte nga ata burra që nuk i solli lufta në rrugën e armëve, por bindja. Kur erdhi koha, ai nuk u tërhoq. U bashkua me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, fillimisht në punën organizative, më pas në radhët e luftëtarëve. Ishte ndër ata që nuk lodheshin së vepruari, në fjalë, në aksion, në përkushtim. Dhe qëndroi i tillë deri në fund të luftës.

Pas çlirimit, nuk e la pushkën. U rreshtua në Divizionin e Mbrojtjes së Popullit, aty ku kërkohet jo vetëm guxim, por edhe qëndrueshmëri në kohë të paqarta.

Reparti i tij ishte gjithmonë në lëvizje. Përballje pas përballjeje. Ndjekje pas ndjekjeje. Një luftë që nuk kishte më front të dukshëm, por po aq rrezik.

Një ditë, një informacion i saktë i çoi përballë një baze armike, në kullën e një agai. Rrethimi u bë i plotë. Heshtja zgjati pak. Pastaj shpërtheu zjarri. Nga dera doli një i armatosur. Krismat u përzierën me thirrje. Koha sikur u ngadalësua.

Veledini nuk priti më. U hodh përpara. Jo sepse nuk e njihte rreziqun, por sepse nuk e pranonte të qëndronte pas. U përball trup me trup. E rrëzoi kundërshtarin. Por në ato çaste, nga një dritare e errët, erdhi goditja që nuk falte.

Ai u lëkund. Ndjeu se po i iknin fuqitë. Dhe ra. Ra siç kishte jetuar: pa u tërhequr. Ra siç luftoi: përpara. Ra siç e meritonte: si një trim.

PËRMBYLLJE

Vijon në faqen 7

80-VJETORI I RËNIES

# HERONJ TË HESHTUR QË DUHEN PËRKUJTUAR

## HERONJ TË HESHTUR QË DUHEN PËRKUJTUAR

(Në kuadrin e 80 vjetorit të rënies)



### Vijon nga faqja 6

Ata nuk lanë pas kujtime të shkruara me dorën e tyre. Lanë diçka më të fortë: shembullin.

Në heshtjen e viteve, emrat e tyre mund të mos përmenden gjithmonë, por pesha e veprës së tyre mbetet. Sepse liria nuk është vetëm një fitore e së kaluarës, është një përgjegjësi që trashëgohet.

Dhe ata, me jetën dhe rënien e tyre, na kujtojnë se çmimi i saj ka qenë gjithmonë i lartë.

Këto figura, ndonëse me profile të ndryshme, bashkohen në disa elemente thelbësore: përkatësinë ndaj një brezi të formuar në luftë, përfshirjen aktive në proceset e ndërtimit të rendit të ri dhe gatishmërinë për sakrificë deri në fund.

Rëndësia e tyre nuk qëndron vetëm në aktin e rënies, por në përfaqësimin e një përvoje kolektive historike. Ata janë dëshmi e një kohe kur individi shpesh vendosej përballë zgjedhjeve ekstreme dhe kur përkushtimi ndaj një ideali merrte formë konkrete në veprim.

Përkujtimi i tyre, në kuadrin e 80-vjetorit të rënies, nuk është thjesht një akt nderimi, por edhe një mundësi për të reflektuar mbi kompleksitetin e asaj periudhe dhe mbi mënyrën se si historia ndërtohet jo vetëm nga figurat e mëdha, por edhe nga ata që mbetën në heshtje.

## Brigada e VIII-të S shkroi me gjak triumfin ndaj fashizmit

### Vijon nga faqja 5

Grykën e Këlcyrës, në kohën kur ishin duke ndarë dhe ngrënë darkën. Armiku i çoroditur e në panik la në këtë luftim të papritur mjaftë të vrarë e të plagosur, ndërsa nga ana jonë nuk pati dëmtime.

I tërbuar nga humbjet e njëpasnjëshme, armiku kundërsulmoi forcat e Brigadës së 8-të me forca të shumta nga Gjirokastra.

Prej datës 17- 26 qershor 1944 për afro dhjetë ditë u zhvilluan luftime të ashpra në Lunxhëri, Çajup, Pogon e Zagori. Në kodrat e Çajupit ra mitralieri trim nga Mallakastra, Imer Xhaferi dhe u plagos partizania Keno Çarçani. Në këto luftime, Brigada bëri një tërheqje taktike në malin e Dhëmbelit. Atje u riorganizua dhe më 30.06.1944 sulmoi përsëri gjermanët në Zagorie, të cilët u detyruan të tërhiqen në Gjirokastër, duke lënë mbi 20 të vrarë e të plagosur. Më 19.7.44 Brigada sulmoi sërish armikun në Gjirokastër. Batalioni i 3-të sulmoi natën në befasi duke i shaktuar armikut humbje të shumta në njerëz e mjete, ndërsa nga forcat partizane ra heroikisht zv/komisari

i kompanisë Hito Gaçe dhe u plagos partizani Ollav Dhame.

Në Gusht '44 Brigada e 8-të mori urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm për të çliruar Konispolin. Luftimet u zhvilluan të ashpra dhe pas 48 orësh (më 28 gusht '44) Konispoli u çlirua. Armiku la më se 10 të vrarë, dhjetra të plagosur; U zunë 21 robër, mbi 17 pushkë e dy mitralozë të lehtë. Ndërkohë u plagos skuadërkomandanti Fejzo Rexhepi nga Mallakastra, u vranë katër partizanë, ndër të cilët edhe komandanti trim i Kompanisë së 3-të Razo Zeneli.

Kjo brigadë ka luftuar për çlirimin e qyteteve të Gjirokastrës, Beratit, Lushnjës dhe Tiranës, si dhe jashtë kuç jve administrativë shqiptarë, duke dhënë një kontribut të madh edhe në çlirimin

e viseve kosovare.

Pas çlirimit të Tiranës, Brigada e 8-të S, me Urdhër të Shtabit të Përgjithshëm marshoi së bashku me forcat e Brigadës së 6-të në tokat e ish-Jugosllavisë, në ndjekje të pushtuesit. Gjatë luftimeve të atjeshme ranë heroikisht Heroi i Popullit Thidhori Mastora dhe komisari trim i batalionit të 3-të, Pano Xixho.

Brigada e 8-të Sulmuese ka lënë në fushën e luftimeve kundër armikut 148 dëshmorë dhe rreth 176 të plagosur, nga këto tre shoqe partizane. Emrat e dëshmorëve të kësaj brigade, të shokëve dhe shoqeve të armëve, të cilët dhanë jetën për atdheun në moshën më të bukur, janë shkruar me shkronja të arta në pantheonin e kombit shqiptar.



## LIBRI

*Roli i shkrimtarit në shoqëri, dhe sidomos i Kadaresë është i pazëvendësueshëm*

# Dantja ynë pa Nobel dhe libri i Topollajt, që rihap debatin për gjenin Kadare

• *“Një shkrimtar është më tepër se një parti, ai është një Atdhe më vete. Ai flet në emër të këtij Atdheu. Një shkrimtar (dhe i referohet Dantes), e rilind atdheun e vet, ai është ekuivalenti, zëdhënësi i vlerave të epokës së tij”, shkruan ndër të tjera Shpendi Topollaj në librin e tij “Kadareja i pavdekshëm”*




**FATMIR MINGULI**

Pikërisht në ditën që gjeniu i letrave tona Ismail Kadare do të mbushte 90 vjet, shtëpia Botuese “Jozef” nxorri librin e shkrimtarit Shpendi Topollaj me titull “Kadareja i pavdekshëm”, ribotim i zgjeruar. Libri çelet me citatin e gjithkohshëm të latinëve të vjetër: “O Kombe! Ruani njerëzit e mëdhenj se përmes tyre do t’ju njihë bota”. Kurse tek ato dy fjalë hyrëse, vetë autori i librit shprehet: “Kur zemra e Ismail Kadaresë pushoi së rrahuri, nuk e di pse më erdhën ndërmend fjalët që dikush kishte thënë për florentinasin e madh Dante Alighieri: “Kurse pas vdekjes nisi “jeta e tij e re”, ajo e pavdekësisë, që e kanë hak vetëm gjenitë e mirëfilltë”. Dhe vazhdon: “Pa dyshim, Ismail ishte Dantja ynë dhe për rrjedhojë, një gjeni, që i dha lavdi si pakkush atdheut tonë. Ishte fat që jetoi gjatë, pasi njësoj si Hygoi, që deri në fund të jetës nuk e lëshoi penën nga dora, duke punuar për veprën epepe dhe mjaft voluminoze “Legjenda e shekujve”, edhe ai nuk reshti së shkruari dhe ngritur me guxim zërin e arsyes për vlerat e larta të shqiptarëve kudo që ata ndodhen, dhe padrejtësitë që i janë bërë atij ndër shekuj. La pas një thesar veprash si trashëgimi e çmuar e kulturës tonë kombëtare, e cila si atëherë kur cerberët e diktaturës vigjëltonin me një fanatizëm të denjë për domenikanin Tomas de Torquemada, ashtu dhe kur demokracia fitoi terrenin e humbur, ndriçoi mendjet e shqiptarëve për nevojën e lirisë, me forcën e një iluministi të vërtetë”. Shpendi, te “Dy fjalë si parathënie” ka vendosur shkrimin e vëllait të tij, Spartakut, intelektualit të shquar, diplomatit dhe mikut të hershëm e besnik të Ismailit, me titullin “Precedenti “Karlfeldt” dhe mundësia e një Nobeli nderi për Kadarenë pas vdekjes”,

artikull i botuar te Gazeta “Panorama” po në 28 janar, pra ditën që ai kishte 90 vjetorin e lindjes. Kushdo që e ka lexuar ose do ta lexojë te ky libër, do të bindet se argumentet, erudicioni, elokuenca dhe logjika e tij, janë plotësisht bindëse dhe të pakundërshtueshme, për të mos thënë, nga apologjitë më të bukura që janë shkruar ndonjëherë për “Nderin e Kombit” tonë Kadare. Sipas Spartakut, Ismaili i përkthyer në mbi 50 gjuhë të ndryshme të Botës së sotme tetëmil-iardëshe, kryemjeshtër dhe luksoz i alegorisë së sofistikuar, ai që jo vetëm i mbijetoi si rrallëkush ferrit stalinist të regjimit të Hoxhës, por edhe për dekada të tëra kaloi në qyngjet e zjarrta të purgatorit të kuq, ka qenë prej dekadash serial kandidat si askush tjetër për ta marrë atë çmim që për turpin e asaj Akademie, ju dha slovenit Peter Handke, atij që përlojej para varrit të kryekriminelit Sllobodan Millosheviç. Shpendi, teksa tregon arsyet e botimit të këtij libri, nuk heziton të kujtojë se ka edhe nga ata shqiptarë që kanë vjellë vrer për Kadarenë. Ai i referohet librit autobiografik të Salman Ruzhdies i cili thosh se: “Mënyra më efikase për të sulmuar një libër është të demonizosh autorin e tij, për ta shndërruar atë në një krijesë me motive të ulta dhe qëllime të liga”. Po ashtu ai sjell pasazhe nga ç’ka shkruar me mençuri e sinqeritet bashkëshortja e tij, shkrimtarja Helena te libri “Kohë e pamjaftueshme”, ku inatçinjtë e ziliqarët arrijnë deri atje sa të thonë marrira të tilla, duke krahasuar Ismail Kadarenë me rrezet gama që vinin nga universi dhe që kombi shqiptar duhej t’i kthente mbrapsht nëse donte të mos dëmtohej.

## POPULLI I TIJ

Por Ismailin e donte me gjithë zemër populli i tij, lexuesit e pafund, pasi ishte ashtu sikurse thosh Tefik Çausi se: “Ai (I.K.), ka ditur të krijojë për masën e lexuesve një letërsi të tillë që ka shërbyer si ushqim shpirtëror i një cilësie të lartë, aq i domosdoshëm për emancipimin tonë kombëtar”. Dhe si për t’u dhënë një përgjigje të merituar kritizërve, Shpendi përmend shembullin e xhuxhave që kur hipin në shpinën e gjigantit, thonë se jemi më të mëdhenj se ai, dhe kujton se si e kanë vlerësuar atë të huajt, si fjala vjen Nicole Zand: “Universal dhe i të gjitha kohrave, duke mbetur gjithaq shqiptar”, Bruce Baëer; “një nga romancierët më të shquar”, “Figaro Litteraire”: kalibrin e jashtëzakonshëm të këtij shekulli”, Guillaume Allary: “më i madhi shkrimtar i gjallë i kohës”, “Histori e Letërsisë Evro-



piane”: “që rrok historinë me një frymë të fuqishme shekspiriane”, e deri tek Alain Bosquet: “Kadareja njihet në të gjithë planetin; të kurorëzosh Kadarenë nuk do të thotë ta emanciposh atë, do të thotë të emancipoheni vetë ju”. Dhe Shpendi e nis librin e tij me shkrimin “Një ditë e paharruar”, qysh mbi gjysmë shekulli më parë, kur Kadareja doli nga selia e Lidhjes, për t’i takuar me Spartakun, i veshur me një palë pantallona gri, një këmishë të lirë, një orë “Ruhla”, nga ato që thuhej se andej ishin me lopatë dhe i kthenin për kusur, dhe syze me skelet të trashë. I thjeshtë dhe njerëzor ishte dhe në sjellje, në fjalët që thoshte, dhe premtimin për të ndihmuar e inkurajuar. Ishte mësuar ta thërrisnin ngado: Ismail, edhe pse ai ishte autori i Gjeneralit të famshëm, Kronikës, Autobiografisë, Dimrit dhe i një sërë novelash dhe poezish të mrekullueshme. Gjatë bisedës, dukej që kishte adhurimin më të madh për Lasgushin, dhe disa kritikë i quante vagabondë, për të cilët duhej gjetur sipas tij, ndonjë rrahës profesionist. Por pas kësaj dukje krejt të zakonshme, fshihej një vullkan i vërtetë që kur shpërthente me krijimet e tij, trondiste gjithë vendin. Por Ismail Kadareja e tronditi vendin edhe me krijimet e mëpastajme, disa nga të cilat i zgjedh kritiku Shpendi Topollaj për t’i trajtuar në këtë libër. Ato janë: romanet “Qyteti pa reklama”, “Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut”, “Darka e gabuar”, “Kur sunduesit grinden”, “Ikja

e shtërgut”, si dhe analizat për ç’kanë shkruar të tjerët në librat e tyre për të, si monografia e Fatime Kullit “Uragani i meteorëve” me nëntitull “Bilal Xhaferri përballë Kadaresë”, libri studimor i Met Dervishit “Intertekstualja dhe disidentja te “Dimri i vetmisë së Madhe”, paskvilet e Kapllan Resulit me titull “Shpifjet e Kadaresë nuk e ndryshojnë të vërtetën”, apo pjesë nga libri i të ndjerit Kastriot Myftaraj “Ballkanadoli gjeostrategjik”.

## NË EMËR TË ATDHEUT

Për Shpendin, roli i shkrimtarit në shoqëri, dhe sidomos i Kadaresë është i pazëvendësueshëm dhe arsyen e gjen po te fjalët e Ismailit i cili tek intervista e tij e botuar te “Kohë barbare” shprehet: “Një shkrimtar është më tepër se një parti, ai është një Atdhe më vete. Ai flet në emër të këtij Atdheu. Një shkrimtar (dhe i referohet Dantes), e rilind atdheun e vet, ai është ekuivalenti, zëdhënësi i vlerave të epokës së tij”. Teksa merret me analizimin e Lul Mazrekut, Shpendi hyn brenda thelbit të problemit që synon Kadareja dhe shkruan: “Dhe shihni ç’ngjet: ndërsa grekët me gojën e Homerit pohonin se kur tërhiqej zvarrë nga Akili, Hektori që i vdekur, e romakët nëpërmjet Virgjilit, mbronin mendimin se Akili ia shpoi këmbët Hektorit dhe në ato vrima futi litarin për ta tërhequr, por që fundja askush nuk e vinte në dyshim, se i prekur nga lutjet e të atit, ai ua ktheu

ESSE

# Letrat e ushtarit grek dhe e majorit rus nga malet e egra të Shqipërisë



Sefer Pasha

Jam në djerni të shënimeve të nobelistit grek Odiseus Eliotis gjatë luftës italo – greke e cila fillojë më 28 tetor 1940, ku ai si nëntoger luftoi në Gjirokastër, Tepelenë dhe Përmet. Por Odiseu Eliotis nuk paska qenë i vetëm. Të tjera letra po botohen për ushtarin grek të kësaj lufte. Ushtari quhej Kostantinos Klampatesa. Ai ishte nga Saidona e Mesenisë. Këtij ushtari në jetë nuk i thërrisnin Kostantinos,

as Kosta, por “Dinos”. Kur shpërtheu lufta e vitit 1940 ai luftoi në frontin shqiptar. Në një nga letrat e ushtarit grek të cilat ai ja dërgon nënës nga larg flitet për “malet e egra” të Shqipërisë, për diellin e shkëlqyer, për lisat të cilët përplasen kokë më kokë, barinj që e lëshojnë tenxheren e kosit në bokërrimë dhe ajo nuk derdhet, mushka të Greqisë me vula në shpatulla, erëra lumi që i kthejnë nga udha breshërit e plumbave. Vjeshta është e ashpër. Kostantinos nënvizon në letra se familjet shqiptare i strehonin fshehtas ushtarët grek të plagosur në netët me “borë dhe mjegull”. Fshatarët të cilët e dinin që ishim armiq na gostisin me mish të pjekur. Zanat e malit na mjekojnë brenda në Përmet. Ai flet gjithashtu për rrobat e leshta dhe për një “lum diku” që ai nuk ja thotë emrin, por me siguri e ka fjalën për lumin Vjosa.

Njëra nga letrat dërguar nënës, Dinos, thotë se shërben në Regjimentin e 6-të të Këmborisë. Letra mban datën 8 shkurt të vitit 1941. Në këtë letër është dhe një fjali ironike për ushtarin italian, ku tekstualisht ai thekson se “na shqetëson vazhdimisht zjarri i kundërshtarit tonë frikakac”. Letrat e Dinos janë që të gjitha të ndjera. Ja një

fragment nga njëra prej këtyre letrave: - “Mora letrat dhe kartolinat tuaja dhe u gëzova që jeni mirë. Edhe unë po ashtu. Gëzoj shëndet të plotë. Rrini të qetë”.

Është interesante të thuhet se në letrat e ushtarit grek të cilat i shkruan që nga “malet e egra” ai ka shtënë me armë ndaj kaçakëve të cilët nuk dihej se nga vinin. Ata hapnin varre dhe mernin unazat, zinxhërë, koburet e argjenda dhe vathët e florinjte. Kaçakët me harta në duar kërkonin thesaret e Ali Pashë Tepelenës.

Jeta e ushtarakëve të huaj që luftuan në Shqipëri është e ngjashme. Identike është dhe një letër e majorit rus e cila u gjet gjatë luftës për çlirim-in e Kosovës në vitin 1999 në fshatin Kamenicë të Tropojës. Edhe majori rus i cili shërbente në ushtarinë e Millosheviçit si mercenar i shkruante nënës se ku ndodhej.

Letra e majorit rus dhe shumë paimë ushtarake i mori në komisarjatin e Tropojës komisar Gani Malushi kur Kosova u çlirua nga pushtuesi serb. Letra e majorit rus u arshivua në sekretarinë e komisarjatisë të Tropojës. Bashkë me letrën e majorit rus u gjetën dhe veshmbathje të shumta ushtarake të ushtrisë së Millosheviçit.

As sot nuk e di se ku përfundojë kjo letër. Moikom Zeqo më tha se duhet kërkuar në Arkivin e Shtetit. Kur ajo u gjet mes teshave të ushtarakëve serb askush nuk u mor me të. Predhat e mitraljerëve serb përplaseshin mbi Majën e Hekurave. Tropoja e Vjetër që bërë fije - fije. Por kërkimet për letrën e majorit rus duhet të përqëndrohen dhe në një drejtim tjetër.

Sa oficer dhe ushtar rus shërbyen në frontin e luftës me Shqipërinë pas bombardimeve të Natos?. Rreziku rus sot është prezent.

Askush nuk u mor me përkthimin e letrës së majorit rus. Nuk e dimë nëse dhe ai i shkruan nënës për “malet e egra” ku ndodhet [është futur në territorin e Shqipërisë] dhe NATO po bombardonte ushtarinë e Millosheviçit. Majori rus nuk është në të njëjtat kushte me ato të ushtarit grek në jug të Shqipërisë.

Pas luftës ushtari grek mbaroi fakultetin e Drejtësisë. Por diktatura e Metaksasit e gjeti Konstantinos Klampatesa në Athinë. E arrestuan më 7 shtator 1941. Ai u burgos në burgun Egina. Një roje e gjakosi dhe Dinos i prangosur iu përgjigj: - “Kujdes mos ndotesh!”. Kurse për majorin rus nuk dihet asgjë.

## Dantja ynë pa Nobel dhe libri i Topollajt, që rihap debatin për gjenin Kadare

Vijon nga faqja 8

trojanëve trupin e të vrrarit, mijra vjet më vonë, në një vend që qëndronte midis tyre, dhe që ndofta qe më i vjetër se ata, do të shfaqeshin ca monstra që do t'ua kalonin në ligësinë e fantazisë dy të parëve, duke inskenuar një vrasje në kufi, me aktorin e dështuar e fatkeq, tashmë ushtar, Lul Mazrekun, për të tmerruar e frikësuar turmat e njerëzve të mjerë, në një kohë që kishin vrrarë sa kishin mundur, vetëm pse donin të baktisnin “parajsën” socialiste, dhe as e kishin marrë mundimin që prindërve të tyre, t'u tregonin të paktën varrin”. Por populli duhej llahtaritur me zvarritje kufomash, ndaj dhe autori i këtij libri thotë: “Dhe këtu të mos ua hamë hakun; intrigat, bëmat dhe krimet e bandës së Enver Hoxhës, do t'i kishin zili edhe ata që bënë shtesat e epokës posthomerike për pallatin e Atridëve; ato do të ishin të denja për penën e Sofokliut, Euripidit e Senekës”. Dhe si për ta vërtetuar këtë, ai huazon diçka nga një personazh i romanit të Kadaresë i cili e mbyll këtë temë: “...më lejoni t'u them se për kësi gjërash ata kishin më shumë përvojë dhe ide se gjithë antikiteti grek e romak të marrë bashkë”. Te shkrimi i tij për romanin “Darka e gabuar”, ndërsa bën fjalë për paradokset e kohës së pas luftës së Dytë në Gjirokastër dhe mjetet artistike që Kadareja përdor, Shpendi nënvizon: “paradoksi i kohës... në penën e Kadaresë merr përmasat e një grotesku që i përdorur dikur nga Rableja (Gar-

gantua dhe Pantagryel”), dhe Shçedrinin (“Historia e një qyteti”), i ka dhënë aq forcë “Kronikës në gur”. Shpendit, leximi i “Kur sunduesit grinden” i kujton se ky libër i mrekullueshëm, jo vetëm të kënaq estetikisht, por edhe të bën të përfytyrosh se nga kaloi aq gabimisht rruga jonë dhe si u luftuan mendjet e ndritura, te të cilët duhej mbështetur e ardhmja e një populli. Duke e mbyllur ligjeratën, ai gati bërtet: “...a do të dalë dikush që të shkojë në Suedi tek ai komisioni që ndan atë çmimin e famshëm dhe duke ua hedhur në tavolinë, t'u thotë: Lexojeni o u plaçin sytë, se mjaft e shkelët testamentin e Alfred Bernhard Nobelit me padrejtësinë që i bëni ndër vite, jo vetëm Ismail Kadaresë, por gjithë popullit shqiptar”. Sa njerëzor e përshtetur Topollajt, Kadarenë, kur shtjellon “Ikja e shtërgut”, bazuar te dashuria platonike e një zemre delikate si ajo e Lasgush Poradecit. Aty ai sheh forcën e shpirtit njerëzor, të vizatuar sipas porosisë tolstojane për thjeshtësinë, lakonizmin dhe qartësinë, si mjete për të mbërritur te përsosmëria e artit.

### ARSYETIMI I PADREJTË

Në këtë libër Shpendi ka përfshirë edhe artikuj mospajtuës e deri polemizues me ata që sikurse e cekëm më lart, duan t'ia ulin vlerat Kadaresë, me arsyetimin e padrejtë se në një farë kuptimi, i ka shërbyer diktaturës, si për shembull artikulli “Ziliqarë! mjaft e sulmuat Kadarenë”. Ai u drejtohet të gjithë atyre që e quajnë Ismail Kadarenë glorifikues-

in e diktatorit, me fjalët e Ciceronit drejtuar Katilinës: “Quoskue tandem?” pra “Deri kur më?” dhe shton se hija e nihilistëve të rinj si Eugjen Bararovi i Turgenievit, ende sillet rrotull nesh. Kurse te shkrimi kundër smirëziut që urren vetë shqiptarët, Kapllan Resulbegoviç thotë: “...kushdo që kërkon ta baltosë me të pavërteta atë (I.K.), duhet të kujtojë fjalët e arta të Charles Colton - it se “Shpifja dëmton më shumë atë që shpif, se atë ndaj të cilit shpifet”.

Do gjejmë në libër dhe pasazhe nga intervistat që ai ka dhënë me gazetarë të ndryshëm, si e ndjera Rezarta Reçi, Migena Sotiri e Luan Laze, rreth figurës madhore të Ismailit. Dhe si për të krijuar një lloj mozaiku, këtu rreshtohen dy poezi, shkruar posaçërisht për Kadarenë, me rastin e botimit të këtij libri, nga poetët e mirënjohur Agim Bajrami dhe Ymer Nurka, si dhe shkrimi i historianit Mečan Hoxha “Gjenia e Kadaresë në penën e Shpendi Topollajt”. Si në të gjithë krijimtarinë e tij shumëplanëshe, ashtu edhe në 45 librat e tij me kritika letrare, ku dallon një kulturë superiore tashmë e njohur e Topollajt, edhe te ky libër të mbetet në mendje jo vetëm horizonti i tij i pamatë, por dhe dashuria e madhe që ai ka për vetë Ismail Kadarenë, si një mbrojtës i patundur i çështjes kombëtare (Kosovë e Çamëri), e demokrat, dhe veprën e tij kolosale. Shpendi shpreh bindjen se të gjithë librat e I. Kadaresë janë të denjë për atë përgjigjen e poetit komik grek, Aristofanit që kur e pyetën

se cili libër ju pëlqen më shumë, u përgjigj: - Atë që filloj ta lexoj duke shpresuar shumë dhe që i jap fund duke përfutur edhe më shumë. Dhe në fund të këtij shkrimi, nuk mund të mos përmend faktin se ky libër jo vetëm nderon gigantin e papërsëritshëm Ismail Kadare, por edhe se morisë së librave të poetit, prozatorit, kritikut, dramaturgut, publicistit, esseistit Shpendi Topollajt, i shtohet një zë mjaft dinjitoz, aq sa do të kujtoj se sa të vërteta janë fjalët e Idriz Dermyshtit, kur te parathënia e librit të tij “Përtej talentit”, shkruan: “Vepra me vlerë dhe vlera e veprave të Shpendit do enden gjatë në kujtesën e kombit tonë. Shpendi hesht, ndërsa jehona e tij ndrin, bubullon... Tashmë, Shpendi është një krijues kombëtar!

Një thënie e Niçes, mendoj se i shkon për shtat Shpendit tonë: “Ju shihni lart, kur kërkon të lartësoheni. Po unë shoh poshtë, sepse jam lart”. Dhe Shpendi është vërtetë lart, ndaj shikon poshtë. Kalli gruri me shumë bukë”. Ja pse do të mbesin përherë aktuale, fjalët e tij përshëndetëse drejtuar të pavdekshmit Ismail Kadare, me rastin e akordimit të titullit “Kalorës i Legjionit të Nderit”: “U mrekullova nga vlerësimi që t'u bë. Pas 500 vjet krenarie me një Princ të Krishterimit në mbrojtje të qytetërimit të Evropës me shpatë, vendit tonë i duhej një Princ i Letërsisë në mbrojtje të kulturës të saj me penë; gjë që ti e realizove kaq bukur. Përherë Atdheu do të të jetë mirënjohës si një nga burrat më të shquar të tij”.

100 VJETORI I LINDJES

# BASHKIM KOZELI:DISA KUJTIME PËR VËLLA BEGATORIN

*“Tu përkushtuam aq shumë luftës së klasave, sa na gllabëroi edhe vete ne, që mbrojtëm me idealizëm parimet”*

Begatorin nuk e kam patur vetëm vëlla, por edhe prind. Ai më rriti kur nëna me la jetim 9 vjeç. Vëlla Begatori sapo ishte martuar. Ai, me të shoqen Florën, edhe kur lindën fëmijët e tyre, mua me konsideronin si djalin e parë.

Një ditë, tek po me kontrollonte detyrat e shtëpisë, vuri re në një faqe të fletores që kisha shkruar disa vargje. E mbylli fletoren dhe me qortoi që të përqendrohesh në mësim. Unë nuk u ndjeva, fillova të shkruaj detyrat. Ai e hapi faqen ku ishte vjersha dhe nisi ta lexojë.

Vjersha ishte për nënën. Vëlla Begatori gëlltiti diçka dhe u largua i heshtur. Të nesërmen në mëngjes, komshiu ynë, shkrimtari Fatmir Gjata, duke zbritur shkallët e katit të dytë, më foli me emër: - Bashkim, mbrëmë Begatori më dha një vjershën tënde. Më pëlqeu. Vazhdo shkruaj! Shkrimtari më dhuroi një kalem kuq e blu dhe më përkedheli në faqe. U lumturova nga fjalët e tij, po më shumë nga kujdesi i vëlla Begatorit; kujdesi e dashuria e të cilit nuk m'u ndanë gjatë gjithë fazave të jetës sime. Një të dielë vëlla Begatori vjen i shoqëruar me një 14 vjeçar me uniformën e bukur të skënderbegasit. Ishte bërë traditë ditën e pushimit, kuadrot ushtarake merrnin në shtëpi e tyre këta ushtarakë të vegjël. Po hanim drekë dhe mua më mbetën sytë tek ai djalë i qethur dhe i pastër, që dukej si gjeneral me spaletat e arta dhe vijën e kuqe në pantallona. Më shkrepin nje dëshirë e beftë për të shkruar në atë shkollë. Kur skënderbegsai u largua, i thashë Begatorit : - Me që edhe Shkolla “Skënderbej” ka program gjimnazi, sikur të shkoj dhe unë atje ? - Pse ?! - Dua të bëhem gjeneral përpara teje.. - i buzëqeshja me pamje lutësi. - E ke menduar mirë ? - Po. - Mos me turpërosh, se atje disiplina është e rreptë dhe profesorët janë kërkues. - Jo, nuk do të të turpëroj. Mirepo e “turpërova” qysh ne tremujorin e parë. Në zarfin e notave që u dërgohej prinderve që na kishin ne kujdestari, Begatori priste që une te kisha notat pesa dhe ndonje katër. Ndërsa unë kisha vetëm një katër dhe të gjitha tresha.. Tri jave me radhë nuk dola liridalje. Prisja si pule lagur te vinte Begatori ne shkollë dhe te me “telendiste”.. Ai nuk erdhi. Qe psikolog. Më siguri pat gjykuar vështirësitë e mia te fillimit dhe më la kohë të merrja veten. Heshtja e tij me vuri me shumë ne sedër për të mos e turpëruar tjetër herë. Kur u nisa për pilot ne ish Bashkimin Sovjetik, vëlla Begatori me përcolli ne Rinas e me tha: - E di që do na nderosh. Por kam dy porosi: mos e meso alkoolin andej, e mos na sill ketej vajze te huaj. Eh, Begatori, vëllai im, , shoku im, , prindi im. ! Ai kishte gjetur adresën time ne Ministrinë e Mbrojtjes dhe nuk priti t'i shkruaja unë i pari, por më dërgoi letër ai. (sebashku me letrën edhe fo-

ton që kam postuar sot ketu). E lexova letrën aq herë sa e mësova përmendësh. Ai ishte gjithë merak se ne po studionim ne rrethana te acaruar te marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike. Në atë letër Begatori nuk me zinte në gojë asgjë politike. Ndoshta, enkas,që të mos ngjallte provokime. Më shkruante me besim e optimizëm , duke iu bere shumë të fala shoqeve te mi. Kur u kthyem ne studentet ne Rinas , mes prinderve te tjerë, ishte Begatori qe fluturonte nga gëzimi. Me Begatorin ishte dhe vëlla Skenderi, për te cilin u çudita i shqetësuar, sepse kishte operuar buzën nga kanceri. Vëlla Begatori nuk më kishte shkruajtur ne letra, për të mos më shqetësuar . Më pas unë u emërova në Shkollën e Aviacionit ne Vlorë. Kur me përcolli, vëlla Begatori me tha buzagaz : - Vlorë ka vajza te bukura, po shiko ndonje nga familje të thjeshtë , jo me poste. Te them te drejtën, unë u rrembeva pas nje vajze te bukur, pa pyetur për familjen e saj. Por per fat, u realizua edhe porosia e dyte e vëlla Begatorit, sepse prinderit e saj paskishin qënë te thjeshte , dhe u bënë për mua prinder te dyte gjatë 30 vjeteve qe jetova në Vlorë. Pasi u fejova dhe botoja poezi, syri me qante për Tiranën. E perfytyroja veten në Bulevardin e Madh, përkrah me Vefin , mes gjallërisë së njerëzve që përshendeshin dhe benin ritualin tradicional te xhiros së mbrëmjes. Ndaj kur vajta në Tiranë i thashë me takt vëlla Begatorit, të mund të ndërhynte për te më rregulluar në ndonjë redaksi të shtypit ushtarak. Ai u prish në fytyrë. Më kuptoi që kisha hall Tiranën, jo gazetën, por nuk më ra në sy. U mjaftua me përgjigjen: - Në të pëlqen gazetar, shkruaj që andej dhe po ta meritosh, do të kërkojnë vetë. Pas pak mu drejtua me një revoltë të brendshme: - Ku kërkon të vish? Të bëhesh kalemxhi që tu shkruash fjalimet dhe artikujt shefave?... Merru me letërsi.. Mos e fut veten në vathë..

U ktheva ne Vlorë duarbosh. Nuk më erdhi hiç mirë. Më dukej se im vella kish mbetur idealist, ndryshe nga mjaft të tjerë. Ishte aq korrekt e i përkushtuar , sa nderhyrjet e favoret i urrente ne kulm, ndërsa sakrificën e ndjente për nder dhe detyrë. Edhe për fëmijët e tij , nuk lëvizti gishtin, por i la të shkonin ne vende të vështira, Djalin e madh Përparimin- tre vjet ne Flotën e Pashalimanit , të dytin , Fatosin, ne Hidrocenralin e Fierzës. Nuk do ta harroj kurrë atë ditë qe e pashë shumë të mërzhitur... Ishte maji i viti 1974. Në Teatrin Popullor po përgatitej drama ime “Si u kalitëm”, për 30 vjetorin e krijimit te Teatrit. Vepra bente fjalë për ngjarjet tragjike te Fraksionit të Vlorës gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare. Proven e përgjithshme e pai Manush Myftiu, anëtar i Byrosë Politike dhe Sekretar i parë i Tiranës. Në fund te shfaqjes M. Myftiu erdhi ne drejtorine e Teatrit dhe nuk na beri ndonje vërejtje. Vëlla Begatori po më priste përjashta. Pasi i thashë me entuziazëm se Manush Myftiu nuk na bëri ndonje vërejtje, e pyeta: - Po ty si t'u duk shfaqja ? - Shfaqja ?...Siç di regjisori Pirro Mani ta ndërtojë. Edhe aktorët shkëlqyen, sidomos Naim Frashëri ne rolin e Sekretarit të Qarkorit dhe Prokop



Begator Kozeli

Mima, ne atë të kryefraksionistit - Po drama a ishte aq tronditëse sa historia e vërtetë ? - Tani që e pashë ne skenë, nuk mu duk histori, por therrëse për sot. .Nuk besoj të ta lejojnë të shfaqet. - Si ?!.. Po shoku Manush tha që... - Lëre shokun Mnaush...Dje unë prita Mehmet Shehun në Shkollën e Bashkuar. Nxinte në fytyrë . Pa pritur e pa kujtuar më foli harbutshe. Mua, Komisarit të Shkollës së Bashkuar “Enver Hoxha”, më quajti beu i Kolonjës. Ia ktheva si me shaka, se nuk isha derë shehlerësh. Ai më pa me inat dhe në mbledhje sokëlliti e hodhi disa okë me baltë për punën time. Nuk u ndjeva. Por me dhimbje kuptova se, ose unë isha kthyer vërtet në një bej, ose janë turbulluar ujjat, atje lart...Se edhe ne një shfaqje teatri , ai ajo e “Njollave të murme”, Mehmeti e pëlqeu, Enveri e hodhi poshtë... Lëri këto tema, Bashkim. Merru më mirë me ngjarje të largëta historike. Ato kanë më shumë patriotizëm. Nga që Ai fliste shumë i mërzhitur, unë nuk u ndjeva, megjithqë isha i bindur se shfaqja do të jepej me që e kish pëlqyer dhe Manush Myftiu. Por... doli fjala e vëlla Begatorit. Ajo shfaqje u la ne heshtje dhe nuk u dha më. .Nuk u muar vesh pse-ja.. Më pas u kuptua se ajo shfaqje për grupin fraksionist të Vlorës ngjante si dy pika uji me grupet “armiqesore” në ushtri , ekonomi e kulturë, që kishin dalë në vitin e 30 vjetorit të Teatrit. Kur vëlla

Begatori u shkarkua nga detyra e Komisarit të Shkollës së Bashkuar, u transferua me ulje detyre në Vlorë. E ndjente se së shpejti do ta pësonte, sepse kishte mbrojtur Petrit Dumen . Një ditë më tha : - Për Petrit Dumen më erdhi shumë keq, por, ç'është e vërteta, një takëm generalësh, që i mbante me afër, qenë bërë agallarë. Dhe më e keqja, tani që i zuri zullumi, po i nxjerrin sytë njeri tjetrit. Shpesh, me vëlla Begatorin bisedonim ne rrugë, jashtë shtëpisë, për t'iu shmangur ndonjë përgjimi. Nje herë , tekta ecte i menduar e më tha: - Kam lexuar mjaft për Revolucionin Francez. .. Një nga udhëheqësit e saj, Robespieri, në fillimet e karrierës së tij si gjykatës i ri, nguroi të nënshkruajë një vendim për dënim me vdekje. Ndërsa si ushëheqës i revolucionit u transformua ne tjetër njeri. Miratoi regjimin e terrorit dhe ideali i tij përfundoi ne krim. Kështu ka gjasa të ketë ndodhur edhe ketu tek ne... Iu përkushtuam aq shumë luftës së klasave, sa na gllabëroi edhe vete ne, që mbrojtëm me idealizëm parimet... Robespieri me të vetët përfundoi në gjyotinë brenda një nate. Ndërsa ne, siç duket, po e përsojmë vit pas viti... Kurrë nuk kisha dëgjuar nga goja e tij fjalë të tilla. Habine e kalova ne heshtje. Për herë të pare vëlla Begatori po përloje... I tillë ka qënë prindi im, vëllai im, shoku im, BEGATORI , i cili besoj se po ma dëgjon atje lart, urimin e 100 vjetorit të pavdekësisë së Tij !

## STUDIMI

# ZHVENDOSJET E QYTETIT TË PUKËS GJATË 110 VITEVE

- Në Pukë filluan përgaditjet për të përkujtuar 110-vjetorin e zhvillimit të Qytetit Pukë, ku është sot (1916-2026).

## XHEMAL MEÇI

## Mjeshtër i Madh, Studiues\*

Qyteti i sotëm i Pukës është zhvendosur më se një herë. Së pari Profesor E. Çabej është shprehur se duhet të ketë qenë aty ku shtrihet sot fshati Kabash. Dhe se emri tij i lashtë vjen nga Vija Publika që do të thotë Rrugë Popullore që vinte që nga brigjet e Adriatikut. Duke ndjekur luginën e Gomsiqes së Poshtëme dhe luginën e Gominës vazhdonte deri në Dardani, bile deri në Odesa e Kostantinopol (Stamboll). Gjurmët Udhë Pukë (Via Publika) i gjejmë edhe në Zadrimë, në lindje, Petkaj (Shën-mëri, Kukës), Ura Pukë etj.

Mirpo, studiuesi i toponimeve të shek. XVI-XVII Kolë Luka thotë se rënia e një rrokjeje me dy bashkëtingëllore në mes të fjalës është e vështirë gjuhërisht. Për Prof. Çabej është vështirë të kundërshtohet. Megjithatë Prof. Çabej nuk ishte strikt. Pranonte edhe diskutimin. Duke u nisur nga kjo i shpreha mendimin se mos' Pukë (Puka) vjen nga At Pikarja nga latinishtja "Në Peshkëve", kur lagjia Peshkëve si emër e vendbanim ka ardhur deri në shekullin tonë. Prof. Çabej, si u përqëndrua pak tha: "Duhet parë!", ( Bisedë më 21 maj 1977, kur ndodhej në Pukë, Kabash për Sesionin Shkenkor për Toponimet). Në hulumtimet në vazhdim del se në përfundim të lagjes Pezhve ekziston toponimi Kodra Gjtets. Në fund të kësaj kodre gjinden mure, si të ishin mure rrethues të një vendbanimi të lashtë. Kroni me ujë të bollshëm, sipër kodrina që e mbronte edhe për siguri, si edhe nga erërat e veriut. Prej aty kalonte një udhë ( sot e dëmtuar) që vinte për fund të Tërbunit dhe lidhej me kalanë e Vigut (Vikus) në Kashnjë. Po kështu kishte dy degëzime, nga jugu, në Syqel, mbi Fush-Lahe ( ku qenë kryer punime nga ushtria jonë për të vendosur Radiolokator, që shihte deri bregdetin e Durrësit. Dega tjetër drejt luginës së epër të Fanit të Madh. Me ndryshimet demografike etj. del se emri latin Pikaria gjuhërisht dha Pukë (P-ja bashkëtingëllore buzore e zëvendësoi I-në grykore me U-në më të përshatëshme, buzore Pi(Pu)).

Kështu u shfaq në Kodër Laçaj ( Kodërhani) emri Pukë që zotëronte edhe lagjet Mehaj, Grykë Proni, Zezë etj.

## KOHA KUR LINDI NEVOJA PËR NDERTIMIN E NJË KALAJE

Me përpjekjet e pushtuesve Osman lindi nevoja për kala (qytezë) përrreth kësaj kodre e cila "u ndërtua 90 vjet më parë". Në vitin 1637 e viziton Fran Bardhi , Ipezhkvi i Zadrimës e i Pukës etj. Pra 1637-90 vjet, rreth vitit 1540 që do të thotë ku u vendos Agai i Kalasë, Dizdari nga familja fisnike Ziu (Preziu me Boç e Pal Mziu) të Shënpalit ( Shpalit, Kabashit). Sado që Frang Bardhi e quan "Gjytetja e Ree ndë Dukagjin" dhe në fjalorin e Tij Latin-Shqip e shënon "Dukagine", prap agajt e



kësaj kështjelle, Dizdari e ruajtën mbiemrine tyre Puka. Kështu Musa Dizdari ( Hoxhë Puka), Nel Puka (kushëri i Dash Agë Dizdari) etj.

Dizdari pat ndërtuar Xhaminë Pukë para afro 400 -vjet më parë. (Sot e rindërtuar si Xhami Historike e Pukës, me interesimin e Myftisë Gëzim Kopani).

Nga pushtuesit serbë 1913-1915 xhamia u kthye në magazinë. Kur erdhën ushtria Austro-Hungareze (Nemcja) u mbajt përsëri si magazinë. Kjo u bë shkas që familjet kryesore të lagjeve të Pukës të kërkonin lirinë e Xhamisë dhe me që aty afër (më në veriperëndim) ishte edhe tyrbja (një varrë i shenjtë). Komanda dhe garnizoni të vendoseshin te Podi i Ferrave. Një kodër e ngritur mbi rrafsh, me zotërim pamjeje e siguri mbrojtjeje. U premtuan ndihmë për pastrimin edhe të sheshit të përbashkët.

Gjatë vitit 1916 Nemcja ndërtoi godinën e parë aty ku është sot ana lindore e Pallatit të Kulturës "Ndue Shyti". Pra këtu u hodhën themelët e para të Pukës së ardhshme Qytet.

Familjet kryesore që morën nismën për këtë themelim ishin:

1. Selim Rexhë Mehaj, kryeplaku (1915-1918).
2. Asllan Hoxhë Dula, Zezaj, Imam.
3. Beqir Ismajl Osman Laçi, Imam.
4. Isuf Selman Qarri, Zezë.
5. Nel Puka me Musa Puka (Hoxhë Puka).
6. Dash Aga i Nutit, Dizdari. I dekoruar



nga Presidenti i Francës, për mikpritjen e personalitetit Justin Gadar, deputet, shkrimtar, mik i Shqipërisë.

Me rëndësi është fakti se edhe disa familje katolike të rëndësishme i mbështetën në këtë kërkesë, si Kol, Mar Vata i Dushit, Marash Marku i Qelzës, Gaspar Thaçi i Kishës famulltare të Qelzës me 10 fshatra, Prekë Kolë Mema i Rrapes etj.. veprimtaritë kulturore artistike si për 7-8 Marsin etj

Kjo ngjarje historike me rëndësi për Pukën qytet e rreth (Nëprefekturë) iu parashtrua kryetarit të Bashkisë zotni Rrok Dodaj që më 3 mars 2026, i cili e mirëpriti dhe premtoi se do të fillojmë me ngritjen e komisionit organizator, përgaditjet e kumtesave dhe të Memorialit.

Edhe Sekretarja e Përgjithshme e Bashkisë, Denisa Meçi e mirëpriti dhe

mori përsipër të ndihmoi për Memorialin.

Filluam t'i quajmë veprimtari në kuadrin e 110-vjetorit të themelimit të qytetit të Pukës. Kështu u veprua me koncertin muziko-letrar e vallesh të realizuara aq artistikisht nga QKFP kushtuar 7-8 Marsit. Gjithashtu shpallja më 7 Mars 2026 "Qytetar Nderi i Pukës" i Mësuesit Shembullor Rustem Niman Furrikut" pas vdekjes. Auditori prej dhjetra të ftuarëve e familjarë të të ndjerit Rustem N. Furriku e duartrokiten me entuziazëm, kur u njoftua se edhe kjo veprimtari u zhvillua në kuadrin e 7 Marsit dhe të 110-vjetorit të themelimit të Qytetit Pukë.

Sigurisht që çdo gjë është në fillimin e vetë, po jo në heshtje nëpërmes mobilizimit i të gjithëve pukasve brenda e jashtë rrethit të Pukës.

\*Pukë, më 13 mars 2026

## OPINION

# Ajatollahu, fati i çdo sundimtarit gjakatar



Gjeneral © Piro Ahmetaj

Sigurisht, po e ndjek me vëmendje të shtuar dinamikën e luftës në Iran, ngjarje që vijon të mbetet në "top lajmet" të Kancelarive dhe Institucioneve të Sigurisë. Në pamundësi për përgjigje të dedikuar ndaj mediave të interesuara, në vijim gjeni përmbledhje rreth peshës gjeopolitike që mbart ndëshkimi shembullor i regjimit të Iranit jo vetëm për paqen në Lindjen e Mesme dhe interesat e SHBA-së por edhe për besimin në Rëndin e Ri/Trump të Sigurisë Globale.

Pikësëpari, përkundër terrorit në studiot-TV nga analistë të gjithëditur, konspiracionistë të marrosur dhe strategjistë mëndjendryshkur, fatkeqësisht edhe gjeneralë të vetë(de)graduuar, përfshi në Tiranë dhe Prishtinë, që bëjnë komente delinkuente dhe qesharake njëherësh: "për të pastruar bunkerët e Enverit, apo mbushur gavetat me rezerva ushqimore për ditën e kiametit", çmoj se ka zero arsye për tu panikosur, pasi Irani ka zero motiv, shanse dhe kapacitete që të sulmojë me raketa territorin e Republikën e Shqipërisë!

Ndërsa edhe si kontributor teknik i negociatave për marrëveshjen e Policimit Ajror, konfirmoj se në mungesë të kapaciteteve për të ushtruar "më vehte", Italia dhe Greqia (në emër të NATO-s, pra jo si marrëdhënie bilaterale) ushtrojnë 24/7 përgjegjësinë e mbrojtjes ajrore të RSh. E thënë më qartë, ose me termat e Nenit-5 (themeli i ngritjes dhe ekzistencës së Aleancës), nëse sulmohet me raketa Manza, Tirana, Konispoli, Vermoshi, jo vetëm do asgjësohen që në Ajër, por pasuesit e Ajatollahut, ose "dijatë e rinj të Iranit", do të marrin përgjigje vdekjeprurëse nga fuqia ajrore e USA/NATO. Asgjësimi nga NATO i 2 raketave drejtuar Turqisë [edhe pse frikacakët Teherani nuk i morën përsipër], e konfirmojnë këtë.

Së dyti, sulmin vdekjeprurës të ushtrisë amerikane ndaj sundimtarit gjakatar (37 vjet), si dhe gardës revolucionare (në fakt terroriste) të Ajatollahut: "e gjej si sprovë të suksesshme të Rendit të Ri Global të Sigurisë, si dhe të fuqisë shkatërrimtare të Ushtrisë Amerikane". Për më tepër, këtë demonstrim të forcës e gjej edhe si ndëshkim shembullor ndaj diktatorëve të ngjashëm, pra të dalldisur nga

fuqia e mbi-pushtetit (Putinit, Kim Jong-ut), që ashtu si bandat terroriste kërcënojnë se, duke përdorur armët bërthamore: "do i bëjnë gjëmën jo vetëm Izraelit dhe SHBA-së, por njerëzimit, rendit global dhe vlerave të qytetërimit!"

Për të argumentuar "fuqinë e pakonkurrueshme dhe shkatërrimtare të SHBA-ve", mjafton të përmendim dy nga sulmet më të suksesshme në historinë moderne të njerëzimit: (a) ndaj bazave bërthamore të Iranit në Qershor 2025, me: "6 avionë B-2 me kosto 2 bilion \$ secili, 37 orë fluturim; 12 bomba me 14 tonë eksploziv secila dhe 60 m thellësi depërtuese, dhjetëra raketa dhe 125 avionë F-35", si dhe (b) arrestimin spektakolar të Maduros, kur "mbi 150 avionë dhe dronë sulmuan njëherësh 20 baza ushtarake, zgjati më pak se 4.45' dhe me zero humbje, duke nxjerrë jashtë luftimi sistemin e mbrojtjes Ajrore të Venezuelës".

Asnjë shtet tjetër në botë (përfshi Kinën dhe Rusinë) nuk zotëron dhe nuk ka për të pasur në 100 vitet që vijnë, fuqi ushtarake për të realizuar operacione të përafërta me këto 2 shembuj!

Prandaj këto sulme, si dhe asgjësimi i raketave që shkelën hapësirën ajrore të Turqisë, shërbejnë edhe si mesazh i forcës ndaj djajve të rinj të Iranit, etj, që: "nëse do të guxojnë të sulmojnë integritetin e cilindo nga 32 vendet e NATO-s, do të ndëshkoheshin në mënyrë shembullore nga fuqia vdekjeprurëse e SHBA-ve, si dhe e Aleancës!"

Thënë sa më sipër, Izraeli, vendet e NATO/BE, por edhe iranianët dhe mbarë njerëzimi do duhet t'i jenë mirënjohësë fuqisë ushtarake të SHBA-ve dhe leadership-it të fortë të Presidentit Donald Trump!

Së treti, kuja turpëruese e medias zyrtare, si dhe militantëve të regjimit të Iranit pas vrasjes së Liderit Suprem, na kujton skenat me ulërima dhe përbetime mjermane (fatkeqësisht edhe me armë dhe uniformë ushtarake) të shoqatave të Enverit pas 20 Shkurtit 1991, për të rivendosur bustin e diktatorit, si dhe shpërfytyrimin e ngjashëm të koreanëve të Veriut për vdekjen e babait të Kim Jong-ut, në dhjetor 2011!?

Për më keq, reagimin e mbetjeve të regjimit, pra trashëgimtarët e Ajatollahut; anëtarët e këshillit të përkohshëm (presidenti kukull, kreu i gjyqësorit vrasës dhe një Jurist i oborrit), si dhe gjeneralët dhe garda e kamikazëve të regjimit, duke sulmuar: "ambasadat dhe bazat USA në Bahrejn, Egjipt, Irak, Izrael, Bregun Perëndimor, Jordani, Kuvajt, Liban, Katar, Arabinë Saudite, Siri, Emiratet e Bashkuara Arabe, Jemen; bazën e UK në Qipro, Azerbajxhanin, etj", i gjej si qasje të dëshpëruara të një bande terroriste, ose të një gjarpri që i kanë prerë kokën. Dhe meqë jemi te pa-fuqia e Iranit për t'u përballur jo vetëm me USA/NATO, por edhe me vendet e rajonit, mjafton të përmendim



reagimin e Emirateve të Bashkuara, ku: "nga 1,305 dronë, 1,229 u rrëzuan, ndërsa nga 221 raketa, 205 u shkatërruan në ajër dhe 14 përfunduan në det".

Gjithësesi, përtej Sindromës së Stokholmit, shpresoj që vrasja e sundimtarit gjakatar (37-vjet), do të shërbejë ljo për t'u dhuruar në tavolinë pushtetin opozitës të Shah-ut në azil], por për të ndezur shpresën e lirisë së popullit, për të zgjuar përgjegjësitë e elitës fisnike të Teheranit si dhe misionin e gjeneratës së re të Iranit: "për ta çliruar dhe transformuar vendin në një shtet modern, që jo vetëm tejkalon krizën aktuale, dhe garanton sigurinë dhe bashkëjetesën paqësore mes mbi 90 milion bashkëatdhetarëve/iranianëve, por edhe që kontribuon si aktor me peshë për paqen dhe stabilitetin e rajonit dhe jo vetëm!"

Së katërti, për sa u përket pretendimeve cinike të Moskës, Pekinit, por "nën zë" edhe ndonjë udhëheqës perëndimor, për t'i marrë leje KS/OKB-së, kujtojmë përgjigjen denigruese që Trump i dha pinjollit të KGB/Putinit në rastin e Iranit dhe Venezuelës: "të ndalë sa më herët gjakderdhjen në Ukrainë", ndërsa rikonfirmoi se: nuk do t'i marrin askujt leje (aq më pak KS/në agoni) për të përdorur fuqinë ushtarake ndaj çdo vendi që ekspozon kërcënim për jetesën e popullit amerikan, integritetin dhe interesat e SHBA-ve".

Për më tepër, vrasja e Ajatollahut: "nuk është pushtim, thyerje e ligjit ndërkom-bëtar dhe as precedent i rrezikshëm, pasi SHBA-të kurrë nuk kanë synuar pushtimin e Iranit". Në të vërtetë: "SHBA janë në luftë vetëm me regjimin e Ajatollahut, për të mos e lejuar prodhimin e armëve shkatërrimtare që kërcënojnë me shfarosje Izraelin dhe prezencën dhe interesat e SHBA-ve, por edhe paqen jo vetëm në rajon"! Kështu, nuk gjej asnjë krahasim me agresionin neo-nazist të Ruisisë, +4 vjet më parë, për pushtimin e Ukrainës, interesave dhe fuqisë ushtarake të Aleancës Euroatlantike

Nga ana tjetër, siç edhe u gjithëpranua edhe në Konferencën e Mynihut: "ndërsa rendi global i ndërthurr pas Luftës së 2-Botërore nuk ekziston më, mbetet do-

mosdoshmëri kritike për të tejkalar fundin pa lavdi të OKB-1945, agoninë burokratike të BE-së, demokracitë fasadë dhe shtetet e gjunjëzuara nga korrupsioni". Kështu, sulmi për ekzekutimin e sundimtarit të Iranit; operacioni për arrestimin e Maduros (që e kishte kthyer Venezuelën në parajsën e narko-terrorizmit dhe interesave ruso-kineze), si dhe ngritja e Bordit të Paqes, vulosën fundin e rendit të vjetër, si dhe konfirmuan themelimin e "Rendit të Ri të Sigurisë, ose paqes së imponuar me fuqinë", që meriton të skalitet me emrin e Presidentit Donald John Trump.

Në shtesë, përtej fundit të rezistencës së gardës terroriste në Iran si dhe luftës barbare të Putinit në Ukrainë, besoj edhe më fort se vetëm falë (super) fuqisë ushtarake të pakonkurrueshme të SHBA-së, si dhe leadership-it të fortë të Trump: "shpresa e paqes, rendi i ri global dhe vlerat e qytetërimit do të triumfojnë mbi mbetjet e Ajatollah-ut, neo-stalinistët dhe neo-milloseviçët, demokracinë burokratike dhe shtetet e dështuara, si dhe mbi-shtetet dhe organizatat apo bandat narkoterroriste".

Ndërsa, duke përsëritur duartrokitjet e merituar për: "pjesëmarrjen e RSh/Kosovës në Bordin-Trump të Paqes; marrëveshjen mes Kroacisë, Kosovës dhe RSh-së; ndërtimin e Bazës Ajrore Kuçovë, rritjen e buxhetit të mbrojtjes dhe modernizimin e fuqisë ushtarake; projektin e Porto-Palermo-s (+Bondsteel-detar të USA/NATO), të ndërthurrur me Korridorin-8; kontributet në interes të sigurisë kolektive dhe në mbështetje të Ukrainës; rolin lider në projektet e përbashkëta, si dhe procesin e integritimit euroatlantik të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor", i çmoj si prova të forcimit të bashkëpunimit/besimit strategjik, fatmirësisht të ndërthurrura me interesat gjeopolitike mes RSh-së dhe SHBA-ve në rajon dhe Mesdhe.

**Autori: Gjeneral © Piro Ahmetaj; Senior Ekspert për Sigurinë dhe Mbrojtjen Kombëtare, Ballkanin si dhe marrëdhëniet me USA/NATO.**

PROFILI

# Dr. Elton Qeli Kardiologu që shëron zemrat dhe shpirtrat e njerëzve



Nga Sakip CAMI

• *I qetë, fjalëpakë dhe i qeshur ai të imponon respekt dhe besim absolut. Me përvojën 20 vjeçare në kardiologji ai dallon edhe me stetoskop shqetësimet e zemrës së pacientit. Ai e ndjek pacientin dhe i ndjek kontrollet po vetë si në Poliklinikën Nr 5 ku shërben si kardiolog ashtu edhe në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve ku kryen ECO dhe provat ushtrimore të pacientëve*

Nga viti 2008-2012 kryen specializimin në sektorin e kardiologjisë dhe diplomohet kardiolog.

Nga viti 2008 e deri më sot ka marrë pjesë në shumë seminare e konferenca shkencore për kardiologjinë të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, në praktika, kurse e trajnime ku është certifikuar

prej tyre. Nga viti 2012-2016 ka shërbyer si kardiolog në QSUNT dhe nga viti 2016 e në vazhdim shërben si kardiolog në Poliklinikën 5 Tiranë dhe në Poliklinikën e Specialiteteve Nr 3. Shërben si lektor në një nga universitet e Tiranës dhe është i pranishëm me këshillat e tij në emisionet mjeksore të TVSh, TV Klan etj.



Këtë portret të paautorizuar e kam shkruar me fjalë shpirti, të mijat dhe të shumë pacientëve, që shohim te Eltoni mjekun dhe njeriun e mirë dhe pa e ekzagjeruar shpëtimtarin tonë. Jemi vizituar edhe në klinika të tjera europiane dhe kanë përcaktuar të njëjtën diagnozë që ka përcaktuar Dr. Eltoni. I qetë, fjalëpakë dhe i qeshur ai të imponon respekt dhe besim absolut. Me përvojën 20 vjeçare në kardiologji ai dallon edhe me stetoskop shqetësimet e zemrës së pacientit. Ai e ndjek pacientin dhe i ndjek kontrollet po vetë si në Poliklinikën Nr 5 ku shërben si kardiolog ashtu edhe në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve ku kryen ECO dhe provat ushtrimore të pacientëve. Është fat që ju ndjek kardiologu Elton Qeli më thotë mjekja e familjes Dr Albana Cami.

**KUSH ËSHTË DR ELTON QELI ?**

Është lindur në Tepelenë në vitin 1980 dhe në vitin 1999 ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera Gjymnazin “Abaz Shehu” të këtij qyteti duke fituar të drejtën e studimit në atë degë që dëshironte për Mjeksi. Në vitin 2005 mbaron me rezultate shumë të mira Fakultetin e Mjeksisë dhe diplomohet Mjek i Përgjithëm. Nga viti 2005 - 2008 shërben në Spitalin e Tepelenës në sektorin e urgjencës ku ka zgjidhur shumë raste të vështira dhe ka shpëtuar shumë jetë njerëzish.



# EDHE PESË YJE NDRIÇOJNË MBI TIRANË

## Poezi nga FRAN CARA\*

Bijtë e shqipës kudo jeni,  
Në kushtrim ju therret vatani  
Dheut të parëve zot t'u dilni,  
Si dikur Gjergj Legjendari.  
Veshur në zi nana Shqipni,  
Gjysëm shtizë rrëzuar flamuri,  
Na u sos jeta në robëri.  
Deti i lotit plas dhe gurin.

\* \* \*

## Atdhetar Zija Agolli



U lëshon zanin djemve të tij:  
-Bijtë e mi ju therret trolli,  
Rrokni pushkët për liri...!

Të katër vëllezërit besa besë,  
Turren vrap në zjarr të luftës.  
Heroikisht në grykë të pushkës.

\* \* \*

## Zemërprush Nexhat Agolli, fluturim nga Italia

-Për liri s'ma pret kush hovin,  
Deri sa të shporret Italia...  
Fitoi luftën, luftën për paqen.  
Në t'parën qeveri t' Maqedonisë,



Katër vjet me zemër të pastër,  
Nder zevkryeminister i Qeverisë.  
Dora e zezë e UDB-së,  
Të parë shqiptarin s'e durojnë.  
Kriminelet e pabesë,  
Në dyzet e nentën e pushkatojnë.

Në mes të Shkupit Nexhat Agolli,  
Si yll ndrinë në ball të historisë.  
Në përmendore madheshtori,

\* \* \*

## Dritë e nder i shqiptarisë



Prej Firence Qemal Agolli,  
Ka ngjeshë armët për liri,  
Zjarr e hekur çdo barbari,  
Si shqiponja në Dibër ka hi.



-Haxhi Lleshi, o mire se të gjeta!  
-Mirë se erdhe o burrë i dheut!  
Mirë se erdhe o djalë i ri,  
Ka nevojë Dibra jonë për ty.

Sa dëgjon zanin arbnor,  
Vëlla Mahmuti, azgan burrë,  
Myslim Peza me zemër në dorë,  
Me ty jam për këtë flalmur.

Zemër luan ky Musa i vogël,  
Ma trim nana ma nuk ban.  
-Japim jetën për këtë vatan.  
Kambë pushtuesi këtu nuk lamë.

Ndër beteja prin i pari,  
Plagët i mposhtë në ball të luftës.  
Nga Tirana në Prishtinë,  
Si hero edhe në qeli burgjesh,  
Heronj të gjallë 104,  
Burrërisht e pritën vdekjen.  
N' mes tyre edhe Musa i vogel,  
Tokës nënë i dhuroi jetën...

\* \* \*

Burrë i urtë Zija Agolli,  
Në rrugën e dijes e të lirisë,  
Në Itali djemtë i përcolli.  
U kthyen lisa të shqiptarisë.  
Si studentë të gjithë shkëlqyen,  
Brez pas brezi tmerr për barbarin.  
Për atdhe jetën s'kursyen,

Gjaku i tyre ndritë në flamur.  
Babë e vëllazen agollianë,  
Rreth flamurit grusht bashkuar.  
Komandant e komisar,  
Në kudhër të jetës farkëtuar...

Gëdhend e kanë në libër t'jetës,  
Heroizmin e tyre të rrallë.  
I dhanë shqipës dritën e shpresës,  
Këta pesë yje mbi Tiranë.  
Në luftën e madhe çlirimtare,  
Nga Tirana, Shkup e Prishtinë,  
Dhe në vrull të punës ndëtimtare,  
Në qiell të shqipës për jetë ndrijnë.

\*Mësues i Gjuhës, i Letësisë dhe i Psikologjisë,  
Tiranë

## PËRURIMI

Një kuvend letrar, kushtuar romanit biografik “Çili”. (Besniku i zemrës)

# HASAN M. SHAHINAJ MES ARSIMIT, LETËRSISË DHE GAZETARISË

*Për njerëzimin, “Vetëm dy gjëra janë të pafundme, gjithësia dhe marrëzia njerëzore. Dhe unë nuk jam i sigurt për të parën”.*

Albert Ainshtain.

## Kadri Tarelli

Në prag të festës së mësuesit “7 Marsi”, pikërisht më, 03, të Marsit 2026, në një nga sallat pranë Prefekturës së Durrësit, u zhvillua një kuvend letrar, kushtuar romanit biografik “Çili”. (Besniku i zemrës), të mësuesit, shkrimtarit dhe gazetarit veteran z. Hasan M. Shahinaj.

Salla u bush plot me miq dhe dashamirë të librit, jo vetëm nga Durrësi, por edhe nga Tirana dhe Dibra.

Falënderim z. Hasan, mik dhe koleg i nderuar, që na bëre pjesë të këtij kuvendi letrar, ku përurohet romani biografik “Çili”. (Besniku i zemrës). Urime!

Bashkë njihemi prej vitesh, si mësues e drejtues shkollash dhe më pas, si krijues në letërsi dhe gazetari, ku ju kini një përvojë mjaft të gjatë.

Gjej rastin që t’u falënderoj edhe një herë, si redaktor dhe korrektor letrar e gjuhësor, të librit tim me poezi, “Koha në vargje”, botuar kohë më parë. Shkrimi titullohej: “Rrugëtim në poezinë, sociale-atdhetare dhe satirike, të Kadri Tarellit” (Recension).

Ndaj ju përmend kudo që bie fjala, për durimin, zotësinë dhe kulturën gjuhësore, si askush tjetër. Për mua, jeni i paarritshëm në korrektim gjuhësor. Nuk e them për t’u bërë qejfin, pasi puna me librin më ka dhënë mundësi të shoh dhe të këndo plot libra në prozë e poezi. Kështu që e dalloj dhe e vlerësoj një punë cilësore me nivel të lartë gjuhësor e drejtshkrimor.

Për librin tuaj, “Çili”. (Besniku i zemrës), nuk kam ç’të them, pasi folën gjerë e gjatë kritikun Vladimir Muça dhe Poete Merita Kuçi Thartori.

E vlerësoj si një lloj pasaporte për çdo krijues, jetëshkrimin dhe veprimtarinë letrare e publicistike që e këndoi Agim Bajrami. Por jam i bindur se në këtë monografi kushtuar jetës tënde, s’besoj se ke lenë pa shprehur të gjitha ndjesitë e kohëve, mundimet, përpjekjet, arritjet, sukseset, fitoret, dështimet dhe zhgënjimet.

Kam përshtypjen, se në jetën e krijuesve ka një ligj të pa shkruar lidhur me monografinë. Disa ia besojnë studiuesve të tjerë, që sado të mundohen nuk mund t’i thonë dot të gjitha. Libri mbetet disi i ftohtë. Ndërkohë ju zgjodhët një udhë tjetër, ta shtrini jetëshkrimin në formë romani, duke vënë në të jo thjesht kujtime, por edhe biseda aty pranë vatrës, apo në mal e lëndina, me “Çilin”, kalin, shokun e zemrës. Jam i bindur se askush veç teje nuk mund t’i përshkruajë ndodhitë, ndjesitë dhe përjetimet që të shpojnë kujtesën edhe kur nuk i mendon. Mjafton një ngacmim dhe rikthesh në ato kohë të shkuara,

që nuk vijnë më. Janë kujtime të femijërisë, pastaj të shkollës “Normale” të Elbasanit, ku u bëre mësues. Më pas Arsimit lartë për gjuhë-letërsi dhe puna e gjatë në arsim, duke bredhur shkollë më shkollë e fshat më fshat, në rrethin e Dibrës e më pas në shkollat e Durrësit, si mësimdhënës dhe drejtues. Jo kushdo ka edhe një pasuri shpirtërore që të nderon, si gazetar e krijues, një fushë që kërkon kohë shtesë, jashtë ziles dhe orëve të mësimt. Kërkon njohuri, durim dhe shpirt idealisti, vullnet dhe përkushtim të veçantë. Veçori që nuk ju mungojnë, pasi gjallojnë edhe tani në moshë të thinjur.

Gjykoj se këndonjësi i zellshëm do të zbulojë vlerat e librit, si mësim për jetën, veçanërisht brezi i ri. Me dëshirë që përvoja dhe ertësia popullore, të bëjë vend dhe të ndriçojë sado pak udhën e gjithsecilit, për ta vlerësuar e nderuar jetën, për ta dashur dhe shërbyer vendit dhe kombit.


Në fjalën e miqve, mes të tjerave vura re se flet me shumë dashuri e nderim, për shkollën “Normale” të Elbasanit, simbolin e Arsimit shqip, si e para Shkollë e Mesme ku flitej dhe mësohej shqip. Shkollë me histori të madhe, që u hap dhe mbijetoi në përudha të trazuar e të vështira për historinë e shtetit dhe kombit Shqiptar. Natyrisht të takon dhe ju takon juve “Normalistëve” të mburreni me mësuesit, nivelin profesional dhe fryma kombëtare, që u kultivua në shpirtin tuaj, për t’i shërbyer brezave si “Misionarë të dijes dhe edukimit”. Kongresi i Manastirit 1908, dhe pas një viti Shkollë “Normale”, 1909, sollën “Mëvetësinë” e Shqipërisë. “Normalja” ishte e gjithë kombit, jo vetëm e Elbasanit.

Besoj nuk do të mërzitesh me mua....! Si gazetarë të vjetër mirëkuptohemi shpejt, pasi kam një pyetje të pazakontë, por nuk dua përgjigje, sepse e di, po aq mirë sa edhe ju....! - Ku është sot kjo shkollë? Pasi në Elbasan nuk ka mbetur asnjë shenjë, për të vendosur, së paku një tufë me lule, me shnimin, “Ndjesë pastë.....!”

Unë jam gjimnazist, pasi arsimin 7-vjeçar dhe të mesëm e mbarova këtu në Durrës, kështu që nuk i kam ato përjetime si ju, por si mësues e ndjej se kemi humbur shumë. Si t’u themi femijëve tanë, nipave dhe mbesave, nxënësve, të rinjve dhe brezave: “Na ishte një herë.....!?” Dhe pse.....!?”

Është po e njëjta pyetje, që para tre vitesh ia bëra veteranit të arsimit kombëtar, elbasanasit Rudolf Deliana, burrë i moshuar rreth 96-vjeç, kryetar i shoqatës “Normalisti”, i cili besoj se na ndjek nga Parajsa.

U ndodhëm në bibliotekën e qytetit, ku Profesor Selman Sheme, (i cili ka



ndërruar jetë para një viti), përurohte librin e tij studimor, kushtuar Çamërisë. Kisha edhe unë fjalën time, por i mbylla letrat. As vetë nuk e di se si mu shkrep dhe i drejtohem kryetarit:

- Profesor i nderuar! Besoj se “Normalisti” është shoqata që ka më shumë anëtarë se të gjitha simotrat, madje të shpërndarë në gjithë trojet Arbnore.


E përmendët në fjalën tuaj, se shumica e nxënësve, kur u hap shkolla, në fillimet e saj, ishin nga Dardania dhe Çamëria. - Po “Normalen” ku e kini.....?

E pashë që u drodh, sytë i u mbushën me lot. Nuk foli...! Nuk më dha përgjigje....! Më erdhi keq që e lëndova pa dashje. E preka në një plagë të pambyllur që na dhemb të gjithëve. Simboli arsimit të Mesëm Shqip, me të cilin krenohet Elbasani dhe mbarë kombi, ishte fshirë nga faja e dheut. A e di kush, pse u mbyll....? Ç’ humbëm e di, po çfarë fituam jo. Me qëllim apo pa dashje.....!

Nuk dua të hyj në hollësi që na trishtojnë. Por ndodhi fare çuditshëm: Një vendim, një firmë dhe pa prituri, shkolla u mbyll në vitin 2010. Nuk shkoi shumë kohë dhe në vitin 2014, shkollës iu dha titulli “Nder i kombit”. Një qeveri e vrau, tjetra e nderoi.....! Kë të shaj, e kë të mbaj.....! Më thoni të qesh apo të qaj.....!?

Dikush me shaka të hidhur mund ta quajë, Shkolla Normale “Dëshmor i demokracisë”. Ndërsa unë do ta quaja, shkolla “Dëshmor i marrëzisë shqiptare”.

Në fund të takimit, z. Gani Roshi, sekretar i përgjithshëm i organizatës “Federata Universale e Paqes”, ardhur



nga Tirana, i dha mikut ton Hasanit, Certifikatë, “Ambasador i Paqes”.

Urime z. Hasan! Jetë dhe shëndet të mirë. Nuk besoj se ky është libri yt i fundit.....! Dëshira dhe vullneti nuk kanë shteruar.....!

**Miqësisht!  
Kadri Tarelli  
Fillim Marsi 2026.**

## SPECIALE

# ERMAL NUFI MERR DREJTIMIN E MBROJTJES: MODERNIZIMI I FA DHE RIJETËZIMI I INDUSTRIJË USHTARAKE, PRIORITET...

**E**shtunë, 07 mars 2026 - Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, mori zyrtarisht detyrën në krye të Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë ceremonisë së marrjes së detyrës, ministri Nufi vlerësoi përgjegjësinë e institucionit për sigurinë kombëtare dhe për rolin e Shqipërisë në arkitekturën e sigurisë ndërkombëtare, duke shprehur mirënjohje për besimin e dhënë nga kryeministri Rama dhe duke vlerësuar kontributin e paraardhësit të tij Vengu, në drejtimin e institucionit dhe mbështetjen ndaj Forcave të Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes theksoi se siguria kombëtare ndërtohet mbi profesionalizmin dhe përkushtimin e efek-

tivëve në uniformë, të komandantëve dhe të strukturave institucionale që garantojnë funksionimin e sistemit të mbrojtjes edhe në kohë sfidash. Ai nënvizoi se prioritetet kryesore të ministrisë do të përqendrohen në modernizimin e kapaciteteve mbrojtëse, zhvillimin e industrisë ushtarake, rritjen e kapaciteteve për përballimin e emergjencave civile dhe nxitjen e inovacionit në fushën e mbrojtjes, në përputhje të plotë me standardet e NATO.

Në përmbyllje, ministri Nufi rikonfirmoi angazhimin e Shqipërisë si një aleate aktive dhe e besueshme në kuadër të Aleancës, duke theksuar se NATO mbetet garancia kryesore për sigurinë dhe stabilitetin e vendit.



## Ermal Nufi - Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë



**Z.** Ermal Nufi, prej marsit 2026, mban funksionin e ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

Në këtë detyrë ai udhëheq politikën e Mbrojtjes dhe Sigurisë së vendit, duke kontribuar në forcimin e rolit të Shqipërisë në NATO, në zhvillimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura dhe në avancimin e bashkëpunimit strategjik me partnerët ndërkombëtarë të sigurisë dhe mbrojtjes.

Para emërimit në këtë detyrë, z. Nufi ka shërbyer si zëvendëssekretar i Përgjithshëm i Kryeministrisë së Republikës së Shqipërisë, ku ka kontribuar në koordinimin ndërinstitucional, mbështetjen ligjore dhe zhvillimin e proceseve të politikbërjes në nivel qendror të qeverisjes. Në këtë rol ai ka qenë i përfshirë në mbështetjen e proceseve vendimmarrëse të Këshillit të Ministrave dhe në koordinimin e iniciativave ligjore dhe institucionale në nivel qeveritar.

Z. Nufi ka përfunduar studimet e nivelit master në Drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 2010. Pas diplomimit ai ka ushtruar profesionin e tij si avokat dhe konsulent ligjor, duke punuar në sektorin privat dhe me organizata vendase dhe ndërkombëtare, me fokus në

të drejtën civile, tregtare dhe çështjet e qeverisjes korporative.

Që prej vitit 2013 është i licencuar si avokat nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe ka shërbyer si anëtar i Këshillit Drejtues të Dhomës së Avokatëve të Tiranës.

Në karrierën e tij profesionale ka mbajtur gjithashtu detyrën e këshilltarit ligjor pranë Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe atë të drejtorit të Kabinetit të Zëvendëskryeministrit.

Ai ka ushtruar gjithashtu funksione drejtuese në bordet e disa institucioneve të administratës publike dhe të sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes. Me vendim të Këshillit të Ministrave, është emëruar kryetar i Bordit Menaxhues të Autoritetit Rrugor shqiptar dhe anëtar i Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ndërsa në cilësinë ex officio ka kryesuar Bordin e Agjencisë Shtetërore të Informacionit Gjeohapësinor. Gjithashtu, ai ka qenë kryetar i Bordit të KAYO sh.a., shoqëri që operon në industrinë e mbrojtjes dhe sigurisë, duke ofruar produkte dhe shërbime për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për tregjet ndërkombëtare.

Z. Ermal Nufi është i martuar dhe ka dy fëmijë.

*Bashkësia ndërkombëtare nuk do të ndërhyjë në zgjedhjen e presidentit në Kosovë*

## Zgjedhja e presidentit, Orav: Çështje e Kosovës, nuk ndërhyjmë

**B**ashkësia ndërkombëtare nuk do të ndërhyjë në zgjedhjen e presidentit në Kosovë, thotë shefi në largim i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, ambasadori Aivo Orav.

Ai thekson se zgjedhja e presidentit apo presidentes është zgjidhje e Kosovës dhe e përfaqësuesve të popullit. Sipas tij, Kosova tashmë është e pjekur dhe nuk ka qasje askush prej aleatëve t'i tregojë se si apo kush të zgjidhet president.

"Zgjedhja e presidentit apo presidentes suaj është zgjedhje juaj. Sigurisht, e parlamentareve tuaj, të cilët sipas Kushtetutës duhet të votojnë dhe të propozojnë kandidat. Nëse askush nuk propozon kandidat, për ne si vëzhgues ndërkombëtarë nuk di çfarë të them. Nuk di cilat janë pritjet nga ne në këtë rast. Por mendoj se Kosova është mjaft e pjekur. Ne nuk kemi qasje që t'ju tregojmë se si të zgjidhni presidentin apo kënd ta zgjidh-

ni", deklaroi ai.

Orav, në një bashkëbisedim me gazetarë para se të largohet nga detyra e shefit të Zyrës së BE-së në Kosovë, foli edhe për kritikën që deputetët e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, i bëjnë korit diplomatik për të mos e vizituar dhe për të bërë presion ndaj Gjykatës Kushtetuese. Ai deklaroi se vizita e tij në Kushtetuese nuk nënkupton interferim në çfarëdo vendimmarrjeje të kësaj gjykate. Gjykata Kushtetuese është në prag të vendimmarrjes për dekretin e presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës, raporton KP, transmeton Klan-kosova.tv.

"Po, kur kam ardhur këtu, kam zhvilluar një vizitë kortuazie tek të gjitha institucionet shtetërore në Kosovë. Nuk e kam vizituar Gjykatën më pas. Por duke marrë parasysh se Kosova dëshiron të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, puna

ime si udhëheqës i zyrës së BE-së këtu nuk ka vetëm të drejtë të vizitohet të gjithë në këtë vend, por e kam edhe obligim që ta bëj këtë gjë. Sepse kemi një marrëveshje. Ju doni të bëheni pjesë e jonë, ne ju duam që ju të jeni pjesë e jonë. Pra duhet të dimë çdo gjë që po ndodh në këtë vend, sigurisht duke përdorur mënyrat ligjore... Është detyrim i yni të vizitohet dhe të flasim me të gjithë. Sigurisht, ne nuk japim këshilla për veprimet, aktakuzat apo gjykimet. Absolutisht jo. Nuk jemi ne dikush që punon pas skenave për të ndikuar në Gjykatën Kushtetuese. Çfarëdo vendimi që do të marrë Gjykata Kushtetuese, i takon asaj dhe ne si Bashkim Evropian jemi të kënaqur me atë vendim", shton Orav.

Ai e quan vitin e kaluar si një vit të humbur për Kosovën për shkak të krizës politike, derisa shpreson që kriza për zgjedhjen e presidentit në 2026 të mos përsëritet.

